

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА  
ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË  
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ  
FACULTY OF LAW

STUDIME PASUNIVERSITARE - CIKLI I DYTË

**MODERNIZIMI I TRASHËGIMISË TESTAMENTARE: VLERËSIMI I  
LIGJSHMËRISË DHE I EFEKTIVITETIT TË TESTAMENTEVE ELEKTRONIKE  
NË SHEKULLIN XXI**

Kandidat:  
ELMEDINA ISMAILI

Mentor:  
Prof.dr. ARTA MERO

Tetovë, 2023

## PËRMBAJTJA

• Deklaratë e originalitetit.....	4
• VËRTETIM.....	5
• Abstrakti.....	6
• Abstract.....	7
• Анстракт .....	8
• Lënda e hulumtimit.....	9
• Qëllimet e hulumtimit.....	10
• Hipotezat.....	11
• Metodologjia e hulumtimit.....	12
• Rëndësia e punimit .....	13
• Hyrje.....	14
• <b>KAPITULLI I PARË</b> .....	15
• Trashëgimia në përgjithësi.....	15
• 1.Rregullimi i të drejtës trashëgimore .....	15
• 2.Trashëgimia ligjore.....	17
• 3.Trashëgimia testamentare.....	18
• <b>KAPITULLI I DYTË</b> .....	20
• Trashëgimia testamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	20
• 1.Kushtet për plotfuqishmërinë e testamentit.....	20
• 2.Pavlefshmëria e testamentit.....	21
• 3.Procedura trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	22
• 4.Llojet e testamenteve të njohura në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut .....	23
• 5.Liria testamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	26
• <b>KAPITULLI I TRETË</b> .....	28
• Testamenti elektronik.....	28
• 1.Nocioni i testamentit elektronik.....	28
• 2.Zhvillimet teknologjike dhe testamentet elektronike në raport me mjedisin jetëso32	
• 3.Siguria kibernetike mbi testamentet elektronike.....	36
• <b>KAPITULLI I KATËRT</b> .....	39
• Testamentet elektronike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	39
• 1.Ndikimi i pandemisë Covid-19 te formulimi i testamenteve .....	39
• 2.Testamentet elektronike në Nevadë .....	40

- 3.Testamentet elektronike në Ohajo ..... 41
- 4.Testamentet elektronike në Floridë ..... 43
- 5.Testamentet elektronike në Virxhinia ..... 45
- 6.Testamentet elektronike në Arizonë ..... 46
- 7.Avantazhet dhe disavantazhet e testamenteve elektronike ..... 48
- **KAPITULLI I PESTË**..... 50
- Raste studimi ..... 50
- 1.Rasti Macdonald v. Master ..... 50
- 2.Rasti i Taylor v. Hold ..... 51
- 3.Akti uniform i testamenteve elektronike..... 52
- **REKOMANDIME**..... 55
- **BIBLIOGRAFIA**..... 57

## Deklaratë e origjinalitetit

Unë Elmedina Ismaili deklaroj se jam autore origjinale e këtij punimi me titull: *“Modernizimi i trashëgimisë testamentare: Vlerësimi i ligjshmërisë dhe i efektivitetit të testamenteve elektronike në shekullin XXI”*. Ky punim asnjëherë nuk është prezantuar për vlerësim para ndonjë institucioni tjetër. Universitetit i barten të drejtat autoriale të punimit, për ta përdorur për qëllime edukativo-arsimore dhe kërkimore. Të gjitha pjesët e huazuara nga burime të ndryshme që më janë nevojitur për sendërtimin e këtij punimi janë cituar sipas rregullave akademike.

## VËRTETIM

Unë Xhelal Zejneli vërtetoj se e kam kryer lektorimin e punimit të magjistraturës me titull "Modernizimi i trashëgimisë testamentare: Vlerësimi i ligjshmërisë dhe i efektivitetit të testamenteve eletronike në shekullin XI të punuar nga Elmedina Ismaili, me mentor Prof.Dr. Arta Selmani-Bakiu.

Punimi është lekturuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti, sa i përket anës gjuhësore, mund edhe të publikohet, përkatësisht të botohet.

Lektorimi i punimit ka përfunduar më 30.11.2023.

Për punën e kryer mbaj përgjegjësi morale dhe profesionale.

Me respekt!

Lektor  
*Xhelal Zejneli*  
Xhelal Zejneli  
Zsae4  
*Xhelal Zejneli*



Tetovë, më 30.11.2023

Të dhëna themelore për lektorin

Xhelal Zejneli, i lindur në Tetovë më 15 maj 1954, profesor i gjuhës shqipe dhe letërsisë pranë gjimnazit "K. Pejçinoviç" të Tetovës, i pensionuar para dy vjetësh, i licencuar dhe i certifikuar si përkthyes dhe si lektor nga institucionet shkencore në Beograd dhe në Prishtinë, me vendbanim në Tetovë, me numër amze 1105954470024; tel.: 070 / 233 — 613; E-mail: [xhelalzejneli@yahoo.com](mailto:xhelalzejneli@yahoo.com).

## Abstrakti

Objekt studimi i kësaj teme të magjistraturës është vlefshmëria e testamentit elektronik dhe efektiviteti i tij. Në këtë punim do ta analizojmë procesin e krijimit të një testamenti elektronik, duke u fokusuar në rregullat dhe në praktikat që e zbatojnë shtetet e zhvilluara. Duke qenë se në vendin tonë ka zbrazësi juridike të caktuara, ne do t'i analizojmë edhe pasojat me të cilat mund të ballafaqohemi gjatë përpilimit të një testamenti elektronik.

Testamenti elektronik, për dallim nga testamentet tradicionale, shkruhet dhe rruhet në mënyrë elektronike. Në të drejtën tonë pozitive, testamenti elektronik nuk njihet, mirëpo në shumë shtete të ShBA-së siç janë: Nevada, Arizona, Florida, Georgia etj., ndarja e pasurisë mund të bëhet edhe me testament elektronik, gjë e cila është e shpjeguar detajisht në kapitujt në vijim.

Kur flasim për përparësitë që sjell testamenti elektronik, do të nisemi nga fakti se sa praktike është në të vërtetë përpilimi i një testamenti të cilin mund ta shkruash, ta firmosësh dhe ta rruash në mënyrë elektronike. Me vetë faktin se nuk të duhet ndihmë juridike për përpilimin e një testamenti, kuptojmë se mënyra digjitale të kursen kohën dhe paratë. Çështje tjetër me rëndësi që është shtjelluar në punim është fakti se testamenti shumë lehtë mund të përditësohet dhe të verifikohet data se cili ka qenë testamenti i fundit i trashëgimlënësit.

Ndërsa kur është fjala për anët negative të hartimit të një testamenti elektronik, do të flasim për rreziqet teknike siç janë mundësia që në testamentin tuaj të ketë qasje ndonjë personi tjetër, pamundësia që në mjetet elektronike të kyçen personat e moshës së shtyrë të popullatës si dhe personat me aftësi të kufizuara. Duhet pasur parasysh edhe faktin se po qe se testamenti rruhet në ndonjë server *online* mund të ndodh që mos të keni qasje në internet.

**Fjalët kyçe:** *testamenti elektronik, trashëgimlënësi, epoka digjitale, nënshkrimet elektronike, vërtetimi.*

## Abstract

The objective of the study for this topic is the value of the electronic will and its effectiveness. In this paper we will be analyzing the process of creating an electronic will, while focusing on the rules and practices that thriving countries go by. Having in mind the legal loopholes in our country, we will also discuss about the consequences we might face while formulating an electronic will.

The electronic will, unlike the traditional will, is written, saved and protected in a computerized way. In our contemporary law, the electronic will is not very well known, however, in many places such as: Nevada, Arizona, Florida, Georgia etc. the electronic will is accepted as a way to pass on inherited wealth, which is explained in detail in the following chapters.

While speaking of the advantages of the electronic will, we will start from its practical way of composition, which you can write, sign and/or save digitally. By not being required to have the support of a legal advisor in its establishment, we understand how the development of telecommunications is saving us time and money. The other important issue that is elaborated in this study is how easy it can be to identify the latest date of modification.

When it comes to disadvantages, we can discuss about technical risks. These include access to the will by other individuals other than the owner, the struggles to use an electronic device by the elderly percent of the population or those with disabilities, or in case if it is saved in an online server, the likelihood of not having access to it due to connectivity issues.

***Key words: Electronic will, Digital era, Electronic Signature, Authentication.***

## Апстракт

Предмет на изучување на оваа магистерска тема е валидноста на електронскиот тестамент и неговата ефикасност. Во ова изучување ќе го анализираме процесот на создавање на електронскиот тестамент, притоа фокусирајќи се на правилата и практиките што ги следат развиените земји. Имајќи ги предвид правните дупки во нашата земја, ќе разговараме и за последиците со кои можеме да се соочиме при составувањето на електронски тестамент.

Електронскиот тестамент, за разлика од традиционалните тестаменти, е напишан, зачуван и заштитен на електронска форма. Во нашето современо право, електронската волја не е призната, но во многу држави во САД како: Невада, Аризона, Флорида, Џорџија итн., се прифаќа поделбата на имотот преку електронски тестамент, што е детално објаснето во следните поглавја.

Кога зборуваме за предностите што ги поседува електронската волја, ќе започнеме со тоа колку е практично да се состави тестамент, кој можете да го напишете, потпишете и зачувате по електронски пат. Со оглед на тоа дека не ви е потребна правна помош за составување тестамент, разбираме дека дигиталниот начин ви заштедува време и пари. Друго важно прашање што е елаборирано во оваа студија е тоа што тестаментот може многу лесно да се ажурира и да се потврди датумот на последниот тестамент на оставителот.

Кога станува збор за недостатоците, ќе разговараме за техничките ризици како што се пристапот до вашиот тестамент од страна на друго лице, тешкотиите за користење на електронски уред од страна на постарите лица на населението или оние со попреченост. Доколку тестаментот е зачуван на онлајн сервер може да се случи да нема пристап до интернет.

***Клучни зборови: Електронски тестамент, Оставител, Дигитална ера, Електронски потписи, Автентикација.***



## Lënda e hulumtimit

Kohët e fundit, zhvillimet e hovshme të teknologjisë arrijnë të zëvendësojnë shumë lloje të veprimeve nga përditshmëria jonë. Përveç anëve pozitive, zhvillimi i hovshëm i shkencës dhe i teknologjisë ngërthen në vete edhe anë negative. Përdorimi i teknologjive në lëmin e punëve juridike ka filluar të inkuadrohet në shumë shtete të botës. Si një çështje interesante, por mjaft praktike, shfaqet edhe përpilimi i testamentit në formë elektronike. Përkundër mangësive ligjore në vendin tonë, zbrazësive juridike dhe nevojës për reforma në legjislacionin trashëgimor, krijimi i një sistemi të sigurt dhe të përshtatshëm për formulimin e testamentit elektronik, mendojmë se do ta lehtësonte shumë këtë procedurë. Kjo risi do ta lehtësonte procedurën e përpilimit të testamenteve, si nga aspekti financiar, ashtu edhe nga aspekti i besueshmërisë së vërtetësisë së saj. Kohët e fundit, çdokush dëshiron që veprimet t'i kryejë në mënyrë më të lehtë dhe më të besueshme. Rrjedhimisht, testamenti elektronik paraqitet si një mundësi e shprehjes efikase të vullnetit të lirë të testamentlënësit, në mënyrë tejet diskrete, pa prezencën e ndonjë dëshmitari dhe pa kosto shtesë. Është e rëndësishme të ceket se testamenti i ri e derogon testamentin e vjetër. Për shkak të avancimit të programeve dhe të pajisjeve digjitale, të testamentet elektronike kjo çështje nuk paraqet kurrfarë problemi. Me fjalë të tjera, nuk është vështirë të verifikohen rrethanat dhe datat e përpilimit të testamenteve nga testamentlënësi.

## Qëllimet e hulumtimit

Koncepti i testamenteve elektronike që njihen edhe si testamentet digjitale është një sferë juridike relativisht e re dhe në zhvillim e sipër. Disa shtete në ShBA kanë filluar t'i zbatojnë ligjet që i rregullojnë testamentet elektronike, ndërkaq specifikat ndryshojnë varësisht nga juridiksionit. Qëllim kryesor i këtij punimi do të jenë hulumtimi i testamentit elektronik, analizimi i rregullimit ligjor të trashëgimisë testamentare në përgjithësi, sfidat dhe perspektivat e trashëgimisë në epokën digjitale, investigimet mbi fizibilitetin dhe sigurinë e testamenteve elektronike, aspektet krahasuese dhe sfidat që paraqiten në përfshirjen e këtyre testamenteve në legjislacionet trashëgimore të tyre.

Në fund do të jepen përfundime dhe rekomandime konkrete të nxjerra nga studimi i kësaj pjese të së drejtës trashëgimore për të dhënë propozime konkrete për reforma në legjislacionin trashëgimor të RMV-së. Në fokus të këtij punimi do të jenë përparësitë që sjell testamenti elektronik, duke theksuar në veçanti epërsinë e tyre ndaj zhvillimeve të tjera teknologjike, me ndikim në sferën juridike të kontratave.

## Hipotezat

Hipotezat që parashtrohen më poshtë do të vërtetohen gjatë përpunimit të tezës:

Hipoteza e parë: Testamenti elektronik, në krahasim me testamentin e zakonshëm, është një opsion më i lehtë dhe më i përshtatshëm për planifikimin e ndarjes së pasurisë.

Hipoteza e dytë: Me zhvillimin e teknologjisë dhe me përdorimin e pajisjeve digjitale, njerëzit gjithmonë dëshirojnë të jenë në hap me botën si dhe ta lehtësojnë zbatimin e veprimeve juridike. Në një të ardhme shumë të afërt, testamentet elektronike do të bëhen gjithnjë më të përshtatshme për shprehjen e vullnetit të fundit të testamentlënësit.

Hipoteza e tretë: Zhvillimi i vendit tonë në aspektin digjital dhe përfshirja e IT-së edhe në sistemin e drejtësisë paraqet sfidë dhe kërkon angazhime të mëdha, njerëz të specializuar në këtë fushë dhe reformim të noterisë dhe të sistemit gjyqësor. Kjo mund të vë në pikëpyetje edhe përdorimin e përditshëm dhe efikas të testamenteve elektronike.

## Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim janë përdorur metodat, si vijon:

Metoda juridike, e cila ndihmon për përcaktimin e saktësisë së normës juridike, nëpërmjet përcaktimit të domethënies së drejtë të saj.

Metoda sociologjike, nëpërmjet të cilës pasqyrohet mënyra dhe intensiteti i zbatimit të normës juridike në shoqëri.

Metoda historike - Aplikimi i kësaj metode synon t'i pasqyrojë ndryshimet që kanë ndodhur lidhur me respektimin e të drejtës për jetë private dhe për jetë familjare.

Metoda e analizës së legjislacionit - Nëpërmjet zbatimit të metodës së analizës dhe të sintezës bëhet i mundur identifikimi i problemeve ligjore aktuale lidhur me respektimin e kësaj të drejte. Kjo metodë ka shërbyer edhe për ta bërë analizën e zbrazësive ligjore në legjislacionet nacionale, si dhe analizën e atyre dispozitave që kanë kuptime të ndryshme, për të cilat paraqitet nevoja e interpretimit të tyre.

Metoda e studimit të rastit – Nëpërmjet studimit të rasteve mendoj se arrijmë në përfundime më të drejta lidhur me dhënien e mendimeve dhe të propozimeve përkitazi me këtë temë.

## Rëndësia e punimit

Qëllimi kryesor për ta zgjedhur këtë teme ka qenë të njihet funksionimi i testamenteve elektronike në shumë vende të botës, përdorimi dhe roli i tyre, shembulli i shteteve të zhvilluara që i përdorin ato në praktikë dhe ngecja të shtetet në zhvillim. Nëpërmjet analizës së testamenteve elektronike dhe përdorimit të tyre në praktikë, ky punim tenton të japë propozime për përshtatjen e tyre në të drejtën pozitive të shteteve, për mbrojtjen juridike nga rreziqet me të cilat ballafaqohet bota teknologjike, e që u kanosen edhe testamenteve elektronike, përdorimi efikas i tyre dhe qëndrimi i RMV-së në raport me shtetet e zhvilluara në këtë sferë.

Duke e bërë analizën e testamenteve elektronike do të tentojmë të nxjerrim një përfundim që do të ishte më i përshtatshëm për qytetarët tanë. Tekefundit, pse të mos punojmë për të sjellë një frymë të re në trashëgiminë testamentare?! Duke qenë se disa vende tashmë e pranojnë testamentin e përpiluar në formën elektronike, përse një gjë e tillë të mos jetë e mundur edhe te ne?!

Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend emigrimi. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës janë larguar nga vendi dhe kanë vajtur për të punuar dhe të jetuar nëpër vende të tjera. Por, në vendlindjet e veta ata kanë pasuri të paluajtshme. Atyre do t'u lehtësohej puna tej mase po që se testamentin do të mundë ta përpilonin *online* nga vendi ku ndodhen.

## Hyrje

Objekt studimi i kësaj teme të magjistraturës është vlefshmëria e testamentit elektronik dhe efektiviteti i saj. Testamentet elektronike në këtë punim do të studiohen për të ardhur në përfundim apo për të parë nëse ndarja e trashëgimisë me testament elektronik është e përshtatshme për vendin ku ne jetojmë, hapat që duhet të ndërmerren për arritjen e këtij objekti, ndryshimet dhe reformat që duhet të bëhen për implementimin e testamenteve elektronike si dhe efektivitetin e tyre.

Punimi përbëhet prej përmbajtjes, katër kapitujve kryesorë, përfundimit dhe bibliografisë së shfrytëzuar për sendërtimin e tij. Në kapitullin e parë do të flasim për institucionet më të rëndësishme të së drejtës trashëgimore, duke shpjeguar nocionin dhe objektin e të drejtës trashëgimore, natyrën juridike të trashëgimisë, kushtet themelore për krijimin e marrëdhënieve juridiko-trashëgimore. Në vijim do të flitet për trashëgiminë ligjore, për trashëgiminë e domosdoshme si dhe për trashëgiminë testamentare.

## KAPITULLI I PARË

### Trashëgimia në përgjithësi

Objekt i trashëgimisë janë të drejtat pasurore të përshtatshme për trashëgim në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Objektin e trashëgimisë e përbëjnë pasuritë e luajtshme dhe ato të paluajtshme që i kanë takuar trashëgimlënësit. Në objektin e trashëgimisë bëjnë pjesë edhe të drejtat pasurore, por vetëm ato që vazhdojnë edhe pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe jo ato që janë të lidhura ngushtë me personalitetin e trashëgimlënësit dhe shuhen me vdekjen e tij.

E drejta trashëgimore bazohet në disa parime themelore: në Parimin e barazisë së trashëgimtarëve; në Parimin e kufizimit të bazave të trashëgimisë; në Parimin e kufizimit të disponimit me testament; në Parimin e suksesorit universal; në Parimin e fitimit të trashëgimisë *ex lege* dhe të trashëgimisë vullnetare; në Parimin e përgjegjësisë së kufizuar të trashëgimtarëve; si dhe në Parimin e oficialitetit të shqyrtimit të trashëgimisë.

#### 1. Rregullimi i të drejtës trashëgimore

Në të drejtën tonë pozitive, e drejta trashëgimore rregullohet parimisht me Ligjin për trashëgimi të miratuar në vitin 1996 dhe i përmban rregullat materiale me të cilat, përveç parimeve themelore, rregullohen edhe trashëgimia ligjore, trashëgimia e domosdoshme dhe trashëgimia testamentare. Që nga hyrja në fuqi, ky ligj nuk ka pësuar ndryshime dhe plotësime thelbësore. Në të kaluarën, e drejta trashëgimore rregullohej sipas Ligjit federativ për trashëgiminë, të vitit 1955: Ky ligj i përmbante të gjitha rregullat materiale dhe formale sa u përket marrëdhënieve trashëgimore. Sot ndërkaq, normat e të drejtës trashëgimore rregullohen në bazë të disa ligjeve.

Burim tjetër i të drejtës trashëgimore është Ligji për pronën dhe për të drejtat e tjera sendore, i vitit 2001, i cili përmban dispozita që e rregullojnë bashkëpronësinë e trashëgimtarëve (nenet 82-91). Me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, të vitit

2001, rregullohet kontrata për ndarjen e pasurisë gjatë jetës (nenet 1022-1028) si dhe kontrata për mbajtje të përhjetshme (nenet 1029-1035). Rregullat formale që e rregullojnë ushtrimin e të drejtave të trashëgimisë rregullohen me Ligjin për procedurën jashtë-kontestuese, të vitit 2008. Me këtë ligj rregullohet procedura e shqyrtimit të trashëgimisë (nenet 120-191). Risia më e rëndësishme e tij janë dispozita ku thuhet se noterët si të besuarit e gjykatës, kanë kompetenca për të ndërmarrë veprime dhe vendime në procedurën e verifikimit (neni 132 paragrafi 1). Gjithashtu, me këtë Ligj është rregulluar edhe procedura për hartimin e testamentit gjyqësor (nenet 251-264), procedura për revokimin e testamentit (neni 265), si dhe procedura e mbajtjes së testamentit (neni 286-294). Duke marrë parasysh kompetencën e noterëve në fushën e trashëgimisë, Ligji për noterinë i vitit 2007 paraqet rëndësi edhe për të drejtën trashëgimore.

Përveç burimeve themelore, si burime shtesë të së drejtës trashëgimore zbatohen edhe: Ligji për familjen, Ligji për mbajtjen e librave të amzës, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, Ligji për fondacionet dhe shoqatat, Ligji për shoqëritë tregtare etj.<sup>1</sup>

Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar edhe disa konventa ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtën trashëgimore, siç është Konventa mbi të drejtën uniforme për formën e testamenteve ndërkombëtare, e ratifikuar në vitin 1977, e cila testamentet ndërkombëtare i përfshin në grupin e testamenteve të rregullta. Rëndësi të veçantë për të drejtën trashëgimore ka edhe Konventa evropiane për të drejtat dhe liritë themelore, e vitit 1950, e cila është ratifikuar nga Maqedonia e Veriut në vitin 1997. Në bazë të kësaj konvente, qytetarëve të Maqedonisë së Veriut, po qe se u shkeleshin të drejtat, u mundësohej që me kushte të caktuara të kërkojnë mbrojtje ligjore pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Në Maqedoninë e Veriut, gjykatat janë autonome dhe të pavarura dhe nga ajo që u tha më lartë kuptojmë se ato gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Bazuar në

---

<sup>1</sup> Micković, D. and Ristov, A. (2020) 'Закон', in *Nasledno pravo*. Skopje: Univerzitet 'Sv. Kiril i Metodij', fq. 33–34.



sa më sipër, jurisprudenca është burim i së drejtës, duke përfshirë edhe të drejtën trashëgimore. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin se ligji nuk mund t'i rregullojë plotësisht të gjitha marrëdhëniet, po qe se ka zbrazësi juridike, gjykatat, duke miratuar vendime, mund të krijojnë një rregull të ri juridik që do të shfaqet si burim i të drejtës trashëgimore. Duke e pasur parasysh këtë, për dallim nga e kaluara, sot praktika gjyqësore e ka karakterin e një burimi shtesë të së drejtës.<sup>2</sup>

## 2. Trashëgimia ligjore

Kjo mënyrë e kalimit të masës trashëgimore nga personi i vdekur te trashëgimtarët bëhet sipas rregullave të caktuara me ligj. Trashëgimia ligjore zbatohet në ato raste ku konstatohet se personi i vdekur nuk ka lënë testament ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij apo kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm. Trashëgimtarët ligjorë thirren në trashëgimi sipas radhës, ku neni 12 i Ligjit për trashëgiminë thekson se trashëgimtarët e rendit më të afërt me trashëgimlënësin i përjashtojnë nga trashëgimia trashëgimtarët e rendit me të largët.<sup>3</sup>

Rregullat e përgjithshme për përcaktimin e rrethit të trashëgimisë ligjore:

- a) Gjinia
- b) Martesa
- c) Të drejtat e personave ndaj të cilëve trashëgimlënësi ka pasur detyrimin e të ushqyerit ose të ruajtjes

Rregullat plotësuese për përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve ligjorë:

Bashkësia jashtëmartesore, të jetuarit në bashkësi me trashëgimlënësin, paaftësia e plotë për punë, gjendja materiale e trashëgimtarëve.

Në shkencën juridike më të njohura janë 3 sisteme për përcaktimin e bazave të formimit të rrethit të trashëgimtarëve ligjorë:

---

<sup>2</sup> Micković, D. and Ristov, A. (2020) 'Закон', in Nasledno pravo. Skopje: Univerzitet 'Sv. Kiril i Metodij', fq.34-36

<sup>3</sup> Neni 12, paragrafi 3 i Ligjit për trashëgimi i RMV-së

- a) *Sistemi i gjakut të përbashkët* - ku përfshihen motra dhe vëllezërit e trashëgimlënësit, si dhe fëmijët dhe prindërit e trashëgimlënësit.
- b) *Sistemi i shkallëve të gjinisë* - ku përfshihen fëmijët dhe prindërit e trashëgimlënësit, nipërit, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat, stërnipërit dhe stërgjyshërit e trashëgimlënësit.
- c) *Sistemi parentelar* - këtu kemi dy nënsisteme: atë parentelar gradual në të cilin nuk zbatohet e drejta e përfaqësimit dhe atë parentelar linear ku zbatohet e drejta e përfaqësimit.<sup>4</sup>

### 3. Trashëgimia testamentare

Trashëgimia testamentare paraqitet si bazë juridike më e fuqishme se trashëgimia ligjore. Trashëgimia testamentare është një koncept në fushën e trashëgimisë që ndërlidhet me kalimin e pasurisë së dikujt pas vdekjes, nëpërmjet një testamenti. Testamenti është punë juridike *mortis causa*, e njëanshme, e revokueshme si dhe punë juridike formale. Personi që përpilon një testament mund t'i përfshijë aty trashëgimtarët e tij. Këta mund të jenë anëtarët e familjes, miqtë, organizatat jofitimprurëse ose çdo person apo subjekt tjetër që vendos ta përfshijë lënësi i testamentit.

Kohët e fundit, sistemet juridike të Francës, të Gjermanisë, të Austrisë dhe të Anglisë kanë ndikuar ndjeshëm në ligjet e trashëgimisë të vendeve të tjera. Kodi civil francez ka shërbyer si model për shumë shtete të Evropës si dhe për shtete të caktuara në ShBA, në Afrikë dhe në Azi. Studimet krahasuese mbi të drejtën private shpesh u referohen rregulloreve gjermane dhe austriake të cilat janë miratuar gjerësisht nga ligjvënësit. Në mënyrë të ngjashme, zgjidhjet ligjore angleze kanë ndikuar në rajonet koloniale, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Australinë, Zelandën e Re dhe Afrikën e Jugut. Pavarësisht nga disa ndryshime, shumica e vendeve ende u përmbahen

---

<sup>4</sup> Podvorica, H. (2010), *E drejta trashëgimore*, Prishtinë.

formave tradicionale të testamenteve, siç janë testamentet holografike, testamentet me dëshmitarë dhe testamentet publike.<sup>5</sup>

Trashëgimia testamentare dallohet nga trashëgimia ligjore për nga fakti se me trashëgiminë testamentare, personi që përpilon testament ka mundësi të kontrollojë mënyrën e ndarjes së pasurisë së tij dhe kush do të jetë trashëgimtar i tij. Megjithatë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ky kontroll mbi ndarjen e pasurisë nëpërmjet testamentit është i kufizuar pasi që trashëgimtarët ligjorë marrin pjesë në trashëgimi pavarësisht nga fakti se trashëgimlënësi ka lënë testament. Nga kjo nënkuptojmë se trashëgimlënësi nuk mund ta ndajë tërë pasurinë trashëgimore të tij me anë të testamentit.

Testamentlënësi, me vullnetin e tij të lirë mund që ta revokojë testamentin në tërësi ose vetëm një pjesë të tij. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se trashëgimia testamentare mund të përjashtohet në rastet kur ekziston një testament tjetër më i vlefshëm ose në rastet kur gjykata e shpall testamentin si të pavlefshëm për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore.

Për t'u shpallur i plotfuqishëm një testament, duhet të jenë plotësuar kushtet e poshtëshënuara:

- Aftësia për përpilimin e testamentit
- Deklarimi i lirë i vullnetit të testamentlënësit
- Forma e testamentit e parashikuar me ligj

---

<sup>5</sup> Załucki, M. (2021) *Solving the 'Problem' of Wills Formalities in the Modern Post-Pandemic Society: Can the Endless Discussion Conclude?* pdf. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3946460](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3946460) (Aksesi i fundit: 23 tetor 2023).

## KAPITULLI I DYTË

### Trashëgimia testamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut

#### 1. Kushtet për plotfuqishmërinë e testamentit

Në kapitullin e kaluar janë cekur kushtet për plotfuqishmërinë e testamentit, ndërsa më poshtë të njëjtat janë shpjeguar në mënyrë të detajuar.

Mundësia që personi fizik të përpilojë testament, në të drejtën objektive civile dhe në doktrinën civile quhet *zotësi për të përpiluar testament* ose zotësi testamentare. Testament mund të përpilojë çdo person i aftë për të gjykuar që ka mbushur moshën 15-vjeçare. Pra, zotësia për të përpiluar testament bazohet në dy parakushte: Personi fizik duhet të ketë mbushur moshën 15-vjeçare dhe të jetë i aftë për të gjykuar.

Plotësimi i moshës 15-vjeçare vërtetohet në bazë të regjistrimit në librat e amzës të lindjeve. Në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, data e lindjes e personit fizik vërtetohet nga të dhënat e certifikatës së lindjes nga libri i amzës i lindjeve ose nga akti i vdekjes i përpiluar nga nëpunësi i gjendjes civile.

Zotësia për të gjykuar nënkupton se lënësi i testamentit është i vetëdijshëm për përpilimin e testamentit dhe e ka të qartë se ky veprim përbën bazë ligjore për ndarjen e pasurisë së tij në rast vdekjeje. Supozohet se personi fizik që ka mbushur 15 vjeç është i aftë për një gjykim të këtillë, ndërsa e kundërta duhet të vërtetohet.

Nëse nuk janë plotësuar të dy parakushtet, testamenti është i pavlefshëm. Por, nëse humbja e aftësisë për të gjykuar ka ndodhur pas përpilimit të testamentit, atëherë ai është i vlefshëm dhe i njëjti nuk mund të revokohet. Njësoj veprohet dhe në rastin kur testamentin e ka përpiluar personi fizik të cilit i është marrë ose i është kufizuar zotësia e veprimit, por i cili në momentin e përpilimit ka qenë i aftë për të gjykuar, d.m.th. në të ashtuquajturat momente të ndritshme (*lucida intervala*). Edhe ky testament është i vlefshëm, me kusht që të vërtetohet ekzistenca e momenteve të ndritshme tek ai person.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Metaj-Stojanova, A. (2022) 'Zotësia për të përpiluar testament', në *Të drejtat e fëmijëve: Sfidat dhe perspektivat e reja*. Tetovë, Maqedonia e Veriut, fq. 175–176.

*Deklarimi i lirë i vullnetit* për përpilimin e testamentit është kusht themelor për vlefshmërinë e një testamenti. Deklarimi i lirë i vullnetit nënkupton disa kushte themelore: Të jesh i lirë nga çdo lloj ndikimi i jashtëm, që do të thotë të mos jesh i detyruar ose i kërcënuar për përgatitjen e testamentit; Të kuptosh natyrën dhe pasojat e përgatitjes së testamentit, të jesh në gjendje të kuptosh qëndrimin tënd dhe në testament t'i shprehësh dëshirat në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme; Të jesh në gjendje të refuzosh ndikimin e mundshëm të ndonjë personi tjetër që mund të ndërhyjë në vullnetin tënd të fundit. Sipas nenit 259 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë jashtë-kontestuese, gjykata është kompetente për të vërtetuar se trashëgimlënësi, vendimin e vet për ta çuar në vend vullnetin e fundit, e ka marrë në mënyrë të lirë, pa kërcënime dhe pa mashtrime, me ndërgjegje të pastër dhe me mendje të kthjellët.<sup>7</sup>

*Forma e testamentit* ndryshon nga legjislacioni në legjislacion, megjithatë disa elemente themelore të formës së testamentit janë të përbashkëta në shumicën e vendeve. Forma të zakonshme të testamentit që janë të parapara edhe në legjislacionin e vendit tonë janë: Testamenti ollograf, Testamenti gjyqësor, Testamenti diplomatik-konsullor, Testamenti ndërkombëtar dhe Testamenti me gojë. Përveç formave të zakonshme, disa vende të botës njohin edhe testamentin me zë apo testamentin elektronik.

## 2. Pavlefshmëria e testamentit

Testamenti shpallet i pavlefshëm po qe se testamentlënësi është detyruar ose është kanosur gjatë përpilimit të tij. Pra ai e ka përpiluar atë testament kundër vullnetit të tij. Në rastet kur vetëm disa pjesë të testamentit janë përpiluar për shkak të dhunës, të mashtrimit apo të kanosjes, atëherë vetëm ato pjesë do të shpallen si të pavlefshme.<sup>8</sup>

Anulimin e një testamenti që supozohet se testamentlënësi e ka përpiluar për shkak të kanosjes, të dhunës ose të mashtrimit, apo në rastet kur testamentlënësi nuk e ka mbushur moshën minimale të përcaktuar me ligj, mund ta kërkojë vetëm një person

---

<sup>7</sup> Neni 259, parag.1, Ligji për procedurë jashtëkontestimore i RMV-së

<sup>8</sup> Neni 63, parag. 4, Ligji për Trashëgimi i RMV-së

që ka interes juridik, brenda një periudhe jo më të gjatë se një vit nga momenti kur mëson për ekzistencën e shkaqeve të pavlefshmërisë së testamentit dhe jo më vonë se dhjetë vjet nga shpallja e testamentit.<sup>9</sup>

Tendenca në botë shkon drejt lehtësimit të kërkesave formale dhe njohjes së vlefshmërisë së testamentit të trashëgimlënësit. Kjo vërehet në zgjidhjet e fundit të zbatuara gjatë pandemisë në vendet si Amerika dhe Australia. Për shembull, ligji holandez disa kërkesa formale, siç është mungesa e nënshkrimit të trashëgimlënësit ose të noterit, i konsideron si arsye për pavlefshmërinë e një testamenti. Megjithatë, kërkesat e tjera formale nuk e bëjnë testamentin automatikisht të pavlefshëm. Dispozita të ngjashme ekzistojnë edhe në vende të tjera, si për shembull në Wales-in e ri Jugor në Australi, në Quebec të Kanadasë, përfshi edhe Kodin uniform të vërtetimit në Shtetet e Bashkuara. Këto dispozita i japin përparësi qëllimit të trashëgimlënësit dhe e njohin vlefshmërinë e një testamenti që nuk i plotëson plotësisht kërkesat formale, por i përmban dëshirat e fundit të trashëgimlënësit. Pritshmëria e shoqërisë përputhet me këtë qasje, pasi një vullnet i fundit i shprehur në mënyrë joformale mbetet i vlefshëm po qe se i pasqyron synimet e trashëgimlënësit dhe mund të ekzekutohet pas vdekjes së tij.<sup>10</sup>

### 3. Procedura trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut procedura trashëgimore ngrihet sipas detyrës zyrtare, d.m.th. kryesisht, nga gjykata kompetente, në momentin kur e pranon aktvdekjen e personit nga regjistri i personave të vdekur. Përveç kësaj, informacionin për vdekjen e trashëgimtarit gjykata e merr edhe nga personat që kanë interes juridik për ngritjen e procedurës trashëgimore. Pra, për fillimin e procedurës së trashëgimisë është e nevojshme që gjykatës t'i dorëzohet certifikata e vdekjes, ndërsa personi që njofton për vdekjen duhet t'i paraqesë të gjitha të dhënat për pasuritë që ka poseduar

---

<sup>9</sup> Neni 64, parag. 1, Ligji për trashëgiminë i RMV-së

<sup>10</sup> Załucki, M. (2021) *Solving the 'Problem' of Wills Formalities in the Modern Post-Pandemic Society: Can the Endless Discussion Conclude?* pdf. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3946460](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3946460) (Aksesi i fundit: 23 tetor 2023).

personi i vdekur. Si bazë për fillimin e procedurës trashëgimore shërben edhe institucioni i shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur.

Sipas Ligjit për trashëgiminë, si trashëgimtarë mund të paraqiten personat, si: pasardhësit e trashëgimtarit, të adoptuarit dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti i ve ose bashkëshortja e ve, prindërit e trashëgimtarit, vëllezërit dhe motrat e trashëgimtarit dhe pasardhësit e tyre si dhe gjyshi dhe gjyshja dhe pasardhësit e tyre.

Moment i rëndësishëm për fillimin e procedurës trashëgimore është të vërtetuarit nëse trashëgimlënësi ka lënë testament. Në rast se ekziston testament për ndarjen e pasurisë së trashëgimlënësit, atëherë si trashëgimtarë paraqiten edhe personat e përfshirë në testament.

Pas tetë ditëve nga dita e fillimit të procedurës, gjykata ia dorëzon lëndën noterit i cili ka autorizim për të ndërmarrë veprime dhe vendime të mëtutjeshme. Gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore është e rëndësishme që palët të angazhojnë avokatë për t'i përfaqësuar ata si pjesëmarrës në procedurë. Noteri i verifikon trashëgimtarët dhe e ndan trashëgiminë ndërmjet tyre. Po që se ka pasuri të paluajtshme në masën trashëgimore, atëherë bëhet edhe regjistrimi i saj në kadastër. Me fjalë të tjera, pasardhësit regjistrohen si pronarë të ri të pronës.<sup>11</sup>

#### 4. Llojet e testamenteve të njohura në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

*Testamenti ollograf* - Testamenti ollograf që ndryshe njihet edhe si *testament i shkruar* është testament privat dhe i rregullt. Konsiderohet testament privat për arsye se gjatë përpilimit të tij nuk përfshihet ndonjë organ shtetëror. Testamenti është i vlefshëm po që se është shkruar me dorën e testamentlënësit dhe është nënshkruar prej tij. Me fjalë të tjera, për të pasur ky testament efekt juridik duhet të jenë plotësuar dy kushte paraprake, e pikërisht: Krejt përmbajtja e testamentit duhet të jetë shkruar me dorën e testamentlënësit dhe të jetë e nënshkruar prej tij. Sipas të drejtës sonë pozitive të trashëgimisë, data dhe vendi i përpilimit të testamentit nuk janë kusht për

---

<sup>11</sup> *Оставинската постапка во Република Македонија (2020) Aleksov.mk*. Gjetur në: <http://www.aleksov.mk/sq/procedura-trashegimore/> (Aksesi i fundit: 12 May 2023).

plotfuqishmërinë e tij. Megjithatë, në ligj është theksuar se shënimi i datës së përpilimit të testamentit paraqet interes.<sup>12</sup>

*Testamenti gjyqësor* - Ky lloj testamenti paraqet akt publik dhe përpilohet në formë të procesverbalit. Testament për trashëgimlënësin mund të përpilojë edhe gjyqtari i gjykatës themelore i cili së pari duhet ta vërtetojë identitetin e trashëgimlënësit. Pasi trashëgimlënësi ta lexojë dhe ta nënshkruajë këtë lloj testamenti, gjyqtari shënon në testament se trashëgimlënësi e ka lexuar dhe e ka nënshkruar atë në prani të tij. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk është në gjendje që të lexojë, atëherë gjyqtari në prani të dy dëshmitarëve ia lexon testamentin trashëgimlënësit. Më pas dëshmitarët dhe trashëgimlënësi e nënshkruajnë atë. Testamenti gjyqësor në të drejtën tonë rregullohet me dispozitat e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore (nenet 261-265).

*Testamenti diplomatik-konsullor*- Testamenti diplomatik-konsullor është testament i rregullt dhe publik i cili gjithmonë përpilohet në formë të shkruar. Testamenti i përpiluar nga një shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit është i vlefshëm sipas dispozitave që vlejné për hartimin e një testamenti gjyqësor nga një përfaqësues diplomatik ose konsullor i RMV-së që ushtrojnë punë konsullore. Ky lloj testamenti ngërthen në vete edhe pjesën e së drejtës që merret me mbrojtjen e shtetasve të një vendi të cilët jetojnë në një vend tjetër, gjë të cilën kohëve të fundit e hasim shumë.

*Testamenti ushtarak* - Testamenti ushtarak është testament i jashtëzakonshëm sepse përpilohet vetëm në gjendje lufte dhe është testament publik për arsye se përpilohet me praninë e ndonjë personi të autorizuar. Testamenti i përpiluar në gjendje lufte është i vlefshëm sipas dispozitave që zbatohen për hartimin e testamentit gjyqësor të personave në detyrë ushtarake, nga komandanti i çetës ose nga ndonjë epror tjetër i rangut të tij ose i rangut më të lartë, ose nga ndonjë person tjetër në prani të eprorëve ushtarakë, si dhe nga çdo epror tjetër i njësitit të caktuar. Ky lloj testamenti pushon të vlejë pasi të kalojnë 60 ditë nga pushimi i gjendjes së luftës. Po qe se testamentlënësi është çmobilizuar, atëherë testamenti pushon të vlejë pas 30 ditëve nga dita e çmobilizimit.

---

<sup>12</sup> Neni 62, paragrafi 2, Ligji mbi trashëgiminë i RMV-së



*Testamenti ndërkombëtar* - Testamenti i përpiluar në formë të testamentit ndërkombëtar pranohet si testament i vlefshëm dhe prodhon efekte juridike, pavarësisht nga vendi se ku është përpiluar i njëjti, ku ndodhet prona e trashëgimlënësit, shtetësia dhe vendbanimi i tij. Ky lloj testamenti është i plotfuqishëm vetëm nëse shteti në të cilin është përpiluar testamenti ose në të cilin trashëgimlënësi ka vendbanim ose vendqëndrim, e ka ratifikuar “*Konventën e Uashingtonit mbi Ligjin uniform për formën e testamentit ndërkombëtar*”. Pas përpilimit të testamentit, trashëgimlënësi në prani të gjyqtarit të gjykatës themelore apo të përfaqësuesit diplomatik ose konsullor dhe dy dëshmitarëve, deklaron se dokumenti është testament i tij dhe se ai është i njoftuar me përmbajtjen e tij. Nëse trashëgimlënësi nuk është në gjendje ta nënshkruajë testamentin, arsyen ja komunikon personit të autorizuar dhe mund të kërkojë nga ai një person tjetër të autorizuar i cili në emër të tij dhe në prani të tij mund ta nënshkruajë testamentin.

*Testamenti me gojë* – Testamentlënësi mund ta deklarojë vullnetin e tij të fundit gojarisht para dy dëshmitarëve, vetëm nëse për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të përpilojë testament me shkrim. Ky lloj testamenti pushon të vlejë 30 ditë pasi të kalojë rrethana e jashtëzakonshme. Me fjalë të tjera, po qe se testamentlënësi ende është gjallë, ai duhet të përpilojë testament të ri. Gjatë përpilimit të testamentit me gojë, dëshmitarët duhet të kenë aftësi të plotë veprimi, ta kuptojnë gjuhën që e flet testamentlënësi dhe të mos jenë në shkallë të caktuar farefisnie me të. Testamentlënësi nuk mund t'i përshijë në pozitën e trashëgimtarëve dëshmitarët, bashkëshortet e tyre apo pasardhësit e tyre. Anulimin e testamentit me gojë për mungesë forme pas ngritjes së procedurës së trashëgimisë, mund ta kërkojë vetëm personi që ka interes juridik, e pikërisht brenda 1 viti nga dita kur ka mësuar për testamentin, por jo më vonë se 10 vjet nga shpallja e testamentit.

*Testamenti noterial* - Ky lloj testamenti ende nuk është i paraparë në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Testamenti noterial për herë të parë është përmendur në Ligjin për noteri të vitit 2007, me çka i njëjti ka filluar të zbatohet edhe në praktikë. Për këtë formë të testamentit vlejné dispozitat e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore që vlejné edhe për përpilimin e testamentit gjyqësor. Praktikisht, testamenti noterial përpilohet njësoj si testamenti gjyqësor, vetëm me ndryshimin e

organit i cili e përpilon atë, që në këtë rast është noteri.<sup>13</sup> Noteri të cilit drejtohet testamentlënësi, ka të drejtë mos ta lejojë përpilimin e testamentit që është në kundërshtim me kushtetutën dhe me ligjin, me rendin publik, me moralin etj. Testamentlënësi vetë e zgjedh noterin para të cilit dëshiron ta shprehë vullnetin e tij të fundit. Noteri, pas dëgjimit të plotë të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit e harton testamentin në formë të aktit noterial, sipas dispozitave që zbatohen për hartimin e testamentit gjyqësor.

Akti i përpilimit të një testamenti noterial duhet të kalojë nëpër katër faza:

- Vërtetimi i identitetit të trashëgimlënësit;
- Formulimi i përmbajtjes së testamentit;
- Nënshkrimi i tekstit të testamentit, pasi të jetë lexuar paraprakisht nga noteri;
- Verifikimi i procesverbalit që e përmban testamentin e trashëgimlënësit.

Gjithashtu është e rëndësishme që noteri ta shënojë edhe orën e nënshkrimit të testamentit. Lëshimi i këtij detaji mund të sjellë pavlefshmërinë relative të vetë aktit.<sup>14</sup>

## 5. Liria testamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut

E drejta pozitive e Republikës së Maqedonisë së Veriut, trashëgiminë testamentare e kufizon nëpërmjet trashëgimisë ligjore të domosdoshme. Për dallim nga disa legjislacione të vendeve të tjera, siç është Mbretëria e Bashkuar, trashëgimia testamentare në vendin tonë nuk paraqet bazë të fortë juridike për ndarjen e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit. Në sistemin juridik të kontinentit evropian, autonomia e vullnetit të personit që e përpilon testamentin e tij nuk është e plotë. Si rezultat, trashëgimlënësi nuk gëzon një liri të plotë në disponimin e pasurisë së tij. Kjo kufizohet për të siguruar mbrojtjen e interesave të një grupi të veçantë trashëgimtarësh të cilët quhen trashëgimtarë të domosdoshëm. Pjesa e pasurisë që i takon këtij grupi të trashëgimtarëve quhet pjesë e domosdoshme e trashëgimisë. Kjo

---

<sup>13</sup> Neni 67-të, Ligji për noteri

<sup>14</sup> Ajdini, Miranda. (2022). Liria e disponimit me testament në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Konflikti në mes normativës dhe praktikës (Punim masteri), Tetovë, fq. 18

pjesë e pasurisë nuk mund të jepet ose disponohet me një testament apo në formë të dhuratës, sepse ligji e rezervon atë për trashëgimtarët e domosdoshëm me norma imperative.<sup>15</sup> Përkundër faktit se *de cujusi* (trashëgimlënësi) ka përpiluar testament për kalimin e pasurisë së tij ndonjë familjari apo personi të tretë, trashëgimtarët ligjorë kanë të drejtë ta kërkojnë pjesën e tyre nga ajo trashëgimi. Në Ligjin për trashëgimi theksohet se trashëgimlënësi me anë të testamentit mund ta ketë në dispozicion pasurinë e tij sipas mënyrës së parashikuar me Ligjin për trashëgimi. Nga kjo del parimi i kufizimit të disponimit me testament. Trashëgimtarë ligjorë janë anëtarët e familjes më e afërt të trashëgimlënësit, siç janë fëmijët dhe bashkëshorti\ja, të adoptuarit, pasardhësit e fëmijëve të trashëgimlënësit, prindërit, si dhe vëllezërit dhe motrat e tij.<sup>16</sup> Që prindërit apo vëllezërit dhe motrat të paraqiten si trashëgimtarë të domosdoshëm duhet të plotësohen disa kushte paraprake, si për shembull mos të kenë të ardhura dhe mos të jenë të aftë për punë. Këta paraqiten në rendin e dytë të trashëgimtarëve, në të kundërtën, bashkëshorti/ja pasjetuese dhe fëmijët si trashëgimtar të domosdoshëm nuk duhet ti plotësojnë kushtet e lartpërmendura.<sup>17</sup> Vlen të theksohet se trashëgimia e domosdoshme shqyrtohet sipas kërkeses se palëve që kanë interes juridik dhe jo *ex officio*.

Kur kemi të bëjmë me situata ku cenohet pjesa e domosdoshme, atëherë bëhet zvogëlimi i disponimit me testament, e nëse kjo nuk mjafton për ta siguruar pjesën e domosdoshme, atëherë mund të kërkohet kthimi i dhuratave të bëra në 90 ditët e fundit të jetës së trashëgimlënësit.

---

<sup>15</sup> Nasufi, I. and Bexheti, V. (2021) *Testamenti elektronik*, fq.7

<sup>16</sup> Neni 30-të, Paragrafi 1i Ligjit për trashëgiminë në RMV.

<sup>17</sup> Neni 30-të, Paragrafi 3-të i Ligjit për trashëgimi në RMV

## KAPITULLI I TRETË

### Testamenti elektronik

#### 1. Nocioni i testamentit elektronik

Duke qenë se e drejta për të disponuar një pronë shtrihet përtej vdekjes, një mënyrë me të cilën trashëgimlënësi mund t'i bëjë të njohura dëshirat e tij / të saj është krijimi i një testamenti që e parashtron planin për shpërndarjen e pasurisë së trashëgimlënësit pas vdekjes. Shekuj me radhë, formalitetet lidhur me testamentin kanë pësuar modifikime. Këtë e ka cekur edhe shkrimtari Mann në një nga veprat e tij: "Për më shumë se treqind vjet, testamentet janë përcaktuar sipas cilësive formale të tyre. Detajet kanë ndryshuar por kërkesat thelbësore formale siç janë shkrimi, nënshkrimi dhe vërtetimi, kanë mbetur konstante dhe të paprekshme."<sup>18</sup>

Megjithatë, zhvillimi i teknologjisë në vitet e fundit mund të sjellë me vete një sërë rrethanash të paparashikuara më parë me të cilat do të ballafaqoheshin gjykatat. Me zhvillimet e kohëve të fundit, testamentet mund të krijohen dhe të ruhen në mënyrë elektronike dhe të prodhojnë efekt juridik njësoj si testamentet e rregullta që përpilohen me shkrim të ndonjë përfaqësues juridik. Ashtu siç përdoren sot, testamentet elektronike mund të nënkuptojnë çdo shkrim brenda një spektri të gjerë, prej një testamenti të shkruar thjesht në një program kompjuterik nga testamentlënësi dhe i ruajtur në mënyrë elektronike, deri te testamentet e nënshkruara nga testamentlënësi me nënshkrim digjital autentik, duke e noterizuar atë testament nëpërmjet video-thirrjeve. Për të qenë ligjrisht të vlefshme, testamentet elektronike zakonisht kërkojnë nënshkrime elektronike që mund të krijohen duke përdorur teknologji të ndryshme, siç janë nënshkrimet digjitale ose biometrike si dhe shenja e gishtërinjve ose njohja e fytyrës. Këto nënshkrime kanë për qëllim ta verifikojnë identitetin dhe qëllimin e testamentlënësit.

---

<sup>18</sup> (2023) Scholarship.law.upenn.edu. Gjetur në:  
[https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3607&context=penn\\_law\\_review](https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3607&context=penn_law_review)  
(Aksesi i fundit: 14 September 2023)

Përderisa shumë juridiksione kërkojnë që dëshmitarët të jenë fizikisht të pranishëm gjatë nënshkrimit të një testamenti, disa të tjerë, nëpërmjet mjeteve të shumta teknologjike, e lejojnë dëshminë nga distanca. Testamentet elektronike duhet të përfshijnë masa të forta sigurie për t'i parandaluar ndërhyrjet kibernetike ose qasjen e paautorizuar. Kriptimi dhe metodat e ruajtjes së sigurt janë thelbësore për ta mbrojtur integritetin e dokumentit. Për dallim nga testamentet e rregullta që mund të humbin ose të dëmtohen, testamentet elektronike mund t'u qasemi më lehtë. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të theksohet se edhe qasja nënkupton sigurimin e dokumentit ngase pas vdekjes së trashëgimlënësit pala përkatëse mund ta gjejë dokumentin digjital dhe mund të ketë akses në të.

Ashtu si testamentet tradicionale, testamentet elektronike mund të revokohen ose përditësohen me ndryshimin e rrethanave. Edhe kryerja e ndryshimeve në testamentet elektronike duhet të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Sipas një artikulli të “*Harvard Law Review*” të vitit 2018, testamenti elektronik shfaqet në tre lloje të ndryshme:

- 1) Testamenti offline. Ky lloj testamenti krijohet dhe rruhet në pajisjen elektronike të trashëgimlënësit. Pra, trashëgimlënësi përdor një softuer hartimi për ta krijuar testamentin e tij të cilin ai e ruan në kompjuterin e tij personal dhe fare nuk është e nevojshme që ky testament të hyjë në internet. Kjo kategori testamentesh ngërthen në vete edhe situatat ku testamentlënësi në kompjuterin e vet e hap Word-in dhe e shënon vullnetin për shpërndarjen e pasurisë pas vdekjes së tij. Vështirësitë funksionale të paraqitura nga këto lloje testamentesh kanë të bëjnë me çështjen e të provuarit të testamentit, kryesisht me mashtrimin apo me lajthimin si dhe me vjetrimin e tyre.<sup>19</sup> Me shfaqjen e testamenteve elektronike si një mundësi, studiuesit paralajmëruan për probabilitetin e ndjeshmërisë së këtyre testamenteve ndaj mashtrimeve, siç është cekur edhe në një artikull të Gerry Beyer-it dhe të Claire Hargrove-it: “Kompjuterët janë makina të përsosura të kopjimit; çdo kopje është një kopje

---

<sup>19</sup> Hlr (2023) What is an ‘electronic will’?, Harvard Law Review. Gjetur në: <https://harvardlawreview.org/print/vol-131/what-is-an-electronic-will/> (Aksesuar: 28 Shtator 2023).

e përsosur që nuk dallohet nga origjinali, duke e bërë shumë të lehtë procesin e ndryshimeve dhe shumë të vështirë procesin e të provuarit se cili version është origjinali”.<sup>20</sup> Ekziston të paktën një zgjidhje teknologjike që është në dispozicion sot për të vlerësuar nëse një testament elektronik *offline* është autentik: “Metadata”- (Informata për të dhënat lidhur me një dokument elektronik). Metadata mund të përfshijë informacion të nevojshëm për ta menaxhuar, për ta arkivuar dhe për ta ruajtur një burim, si për shembull kur është krijuar, nëse është ndryshuar dhe kush mund t’i qaset. Gjithashtu mund të ndihmojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me autenticitetin e dokumentit. Megjithatë, Metadata nuk mund të vërtetojë nëse trashëgimlënësi e ka shprehur vullnetin e tij të fundit nën kërcenim nga ndonjë person i tretë apo nëse dikush, duke iu qasur kompjuterit personal të trashëgimlënësit, ka ruajtur ndonjë dokument me pretendimin se është vullneti i fundit i trashëgimlënësit. Një aspekt tjetër që duhet pasur parasysh është vjetrimi i testamenteve elektronike *offline*. Testamentet duhet të jenë të vlefshme për shumë vite apo dekada pas krijimit të tyre. Prandaj, është thelbësore të sigurohet që dokumenti digjital i vullnetit të fundit të testamentlënësit gjithmonë të mbetet i paprekur dhe në të akses të mos ketë kush tjetër. Në anën tjetër, dokumentet e shkruara në letër, me kalimin e kohës mund të degradohen, ndërsa skedarët elektronikë përballen me një sërë dobësisht të tjera. Qasja në një dokument digjital kërkon të kesh pajisje dhe softuer të përshtatshëm për t’i lexuar dhe për t’i interpretuar të dhënat e një dokumenti. Testamentet elektronike *offline*, në krahasim me testamentet elektronike *online*, janë të ndjeshme ndaj kësaj çështjeje. Kjo vjen pasi që testamentet elektronike *offline* rruhen në hard diskun lokal të një pajisjeje elektronike. Me kalimin e kohës, mund të ndodhë që pajisja të asgjësohet dhe si pasojë të humbin edhe dokumentet.

---

<sup>20</sup> Beyer, G.W. and Hargrove, C.G. (2009) ‘Digital Wills: Has the Time Come for Wills to Join the Digital Revolution?’, ResearchGate, 33, p. 291.  
doi:[https://www.researchgate.net/publication/228223096\\_Digital\\_Wills\\_Has\\_the\\_Time\\_Come\\_for\\_Wills\\_to\\_Join\\_the\\_Digital\\_Revolution](https://www.researchgate.net/publication/228223096_Digital_Wills_Has_the_Time_Come_for_Wills_to_Join_the_Digital_Revolution).

- 2) Testamentet *Online*. Përderisa testamentet elektronike offline rëndom mbështeten vetëm në veprimet e një personi, pra të trashëgimlënësit, testamentet online përfshijnë edhe persona të tjerë gjatë procesit të krijimit të tyre. Testamentet elektronike *online* u referohen testeenteve të hartuara dhe të ruajtura nëpërmjet shërbimeve të palëve të treta, në të cilat këto shërbime nuk kanë ndonjë detyrim të veçantë për ta mbrojtur testamentin e trashëgimlënësit dhe nuk i obligon ndonjë rregullore unike lidhur me ruajtjen e testeenteve elektronike. Rrjedhimisht, përdorimi i shërbimit të palës së tretë nga ana e trashëgimlënësit është krejtësisht i rastësishëm.
- 3) Testamentet elektronike të kujdestarit të kualifikuar. Lloji i fundit i testamentit elektronik është testamenti elektronik i kujdestarit të kualifikuar, ku ky i fundit i menaxhon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me disponimin e testeenteve të të gjithë klientëve.<sup>21</sup> Këto lloje testeentesh përfshijnë skenarin ku një organizatë fitimprurëse merr përsipër përgjegjësinë për të shërbyer si “kujdestar i kualifikuar” që do të marrë përsipër detyrën për krijimin, për vërtetimin dhe për ruajtjen e sigurt të testamentit të trashëgimlënësit, në përputhje me udhëzimet dhe me kërkesat specifike të përcaktuara nga shteti. Zakonisht, organizata synon ta thjeshtësojë procesin e krijimit dhe të vërtetimit të testeenteve duke ofruar shërbimet online të dëshmitarëve ose të noterëve, siç janë takimet me kamera në internet. Përveç kësaj, ata marrin përsipër të ruajnë në mënyrë të sigurt testamentin e trashëgimlënësit në një format lehtësisht të arritshëm për një afat të paracaktuar, duke siguruar vënien e tij në dispozicion edhe në të ardhmen. Testamentet me kujdestar të kualifikuar dallohen nga testamentet elektronike standarde online, për arsye se platforma e përdorur nga trashëgimlënësi është ndërtuar për të lehtësuar gjenerimin dhe zyrtarizimin e testeenteve elektronike. Fokusi në respektimin e provave të vlerësimit të testeenteve elektronike online dhe offline është shumë më pak i theksuar kur kemi të bëjmë me testamentet elektronike që i janë besuar një kujdestari të kualifikuar. Kështu sepse qëllimi kryesorë i një

---

<sup>21</sup> Милошевић, Д.Т.Ђ. (2022) ЕЛЕКТРОНСКИ ТЕСТАМЕНТ. pdf. Gjetur në: <https://scidar.kg.ac.rs/bitstream/123456789/14595/1/18%20%20Zbornik-19-1082-405-414.pdf>, fq: 411, (Aksesi i fundit: 20 October 2023).

kujdestari është të mbledhë me përpikëri dhe t'i mbrojë provat lidhur me qëllimet e trashëgimlënësit, ndërsa sfidat më të mëdha lidhur me provat për testamentet elektronike online dhe offline shpeshherë kanë të bëjnë me vërtetimin e mungesës së mashtrimit dhe të sigurimit të ruajtjes së sigurt të vullnetit në formë digjitale. Kujdestarët e kualifikuar janë të aftë për t'i zgjidhur me shpejtësi të dyja këto çështje. Për shembull, nëpërmjet dokumentimit të procedurës së ekzekutimit të një testamenti online, një kujdestar i kualifikuar mund të garantojë ruajtjen e provave më bindëse që dëshmojnë për qëllimin e trashëgimlënësit. Për më tepër, duke garantuar aksesin afatgjatë të testamentit të një testamentlënësi ndër vite apo edhe dekada, një kujdestar i kualifikuar mund t'i lehtësojë shqetësimet që zakonisht ndërlidhen me vjetrimin teknologjik.<sup>22</sup>

Përfundimi që del nga këto konsiderata është se çështja e sigurimit të besueshmërisë së trashëgimisë me testament elektronik është i lidhur ngushtë me politikën e mbrojtjes së të dhënave dhe duhet të konsiderohet vetëm në ndërvarësi me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.<sup>23</sup> S'ka dyshim se rëndësia e përvetësimit të një strategjie kohezive për testamentet elektronike bëhet gjithnjë e më e dukshme kur merret parasysh mundësia e rritjes së popullaritetit të tyre në një të ardhme të afërt.

## 2. Zhvillimet teknologjike dhe testamentet elektronike në raport me mjedisin jetësor

Vende të ndryshme në botë kanë kërkesa ligjore specifike për përgatitjen e një testamenti të vlefshëm. Megjithatë, pandemia e Covid-19 nxori në pah kufizimet e këtyre formaliteteve. Fokusi duhet të jetë në respektimin e qëllimit të trashëgimlënësit, edhe nëse ai e shpreh atë në mënyrë joformale. Disa vende, veçanërisht në juridiksionet ku zbatohet e drejta anglosaksone, si Australia dhe

---

<sup>22</sup> Hlr (2023) What is an 'electronic will'?, Harvard Law Review. Gjetur në: <https://harvardlawreview.org/print/vol-131/what-is-an-electronic-will/> fq. 1806-1807, (Aksesuar: 29 shtator 2023).

<sup>23</sup> Милошевић, Д.Т.Ђ. (2022) ЕЛЕКТРОНСКИ ТЕСТАМЕНТ. pdf. Gjetur në: <https://scidar.kg.ac.rs/bitstream/123456789/14595/1/18%20%20Zbornik-19-1082-405-414.pdf>, fq: 411, (Aksesi i fundit: 20 October 2023).



Shtetet e Bashkuara, kanë miratuar zgjidhje që i japin përparësi respektimit të konsiderueshëm dhe të përpiktë të formaliteteve. Megjithatë, këto zgjidhje nuk i marrin parasysh rrethanat e ndryshme që mund të lindin në praktikë apo metodat e reja të krijimit të testamenteve. Si rezultat, rriten nevojat për ndryshime statusore në formalitetet e testamenteve.<sup>24</sup>

Testamentet elektronike kanë fituar vëmendje për shkak të përparimeve në teknologji dhe ndryshimeve në rregulloret ligjore që synojnë të përshtatin epokën digjitale. Më poshtë do të cekim disa nga zhvillimet dhe konsideratat kryesore teknologjike në lidhje me testamentet elektronike:

- I. Teknologjia e nënshkrimit digjital: Testamentet elektronike kërkojnë një metodë të sigurt që individët t'i nënshkruajnë ato në mënyrë digjitale. Teknologjitë kriptografike dhe platformat e nënshkrimit digjital janë përdorur për të siguruar vërtetësinë e nënshkrimit të trashëgimlënësit. Këto teknologji ndihmojnë për të verifikuar nëse testamenti nuk është dëmtuar dhe nëse nënshkrimi është i vërtetë. Kjo mundëson për të parë se si funksionojnë nënshkrimet digjitale në kontekstin e testamenteve elektronike: Testamentlënësi e nënshkruan dokumentin në mënyrë digjitale duke përdorur algoritme dhe çelësa të kriptuar. Algoritmet kriptografike përdoren për të krijuar një nënshkrim digjital unik për dokumentin e testamentit. Ky proces përfshin përdorimin e një çelësi privat për të gjeneruar nënshkrimin si dhe të një çelësi publik përkatës për ta verifikuar atë. Për ta vërtetuar kohën e nënshkrimit të testamentit, atij mund t'i shtohet një vulë digjitale kohore. Kjo vulë zakonisht sigurohet nga një autoritet i besuar, përkatësisht nga një palë e tretë që ofron shërbime të tilla. Nënshkrimet digjitale ndihmojnë në verifikimin e identitetit të trashëgimlënësit duke e lidhur nënshkrimin e tyre digjital me identitetin e tyre, zakonisht nëpërmjet metodave të sigurta të vërtetimit. Nënshkrimet e tilla zakonisht sigurojnë që testamenti të mos jetë ndryshuar që kur është nënshkruar. Po qe se në dokument bëhet ndonjë

---

<sup>24</sup> Załucki, M. (2021) *Solving the 'Problem' of Wills Formalities in the Modern Post-Pandemic Society: Can the Endless Discussion Conclude?* pdf. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3946460](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3946460) (Aksesi i fundit: 23 tetor 2023).

ndryshim, atëherë verifikimi i nënshkrimit digjital dështon. Kur testamenti duhet të ekzekutohet. Ai mund të verifikohet me krahasimin e nënshkrimit digjital duke e përdorur çelësin publik për t'u siguruar se përputhet me nënshkrimin e trashëgimlënësit. Ky proces verifikimi e konfirmon vërtetësinë dhe integritetin e testamentit. Njohja e nënshkrimeve digjitale në testamentet elektronike varet nga ligjet dhe nga rregulloret specifike në juridiksionin ku krijohet dhe ekzekutohet testamenti. Shumë juridiksione i kanë përditësuar ligjet e tyre për të pranuar nënshkrime digjitale në testament, ndërsa të tjerat mund të kenë kërkesa më të ashpra.<sup>25</sup>

- II. Verifikimi I identitetit: Një nga sfidat kritike me testamentet elektronike është verifikimi i identitetit të trashëgimlënësit. Metoda të ndryshme, të tilla si vërtetimi biometrik, vërtetimi me shumë faktorë dhe verifikimi me video janë eksploruar për t'u siguruar se personi që e krijon testamentin është pikërisht ai që pretendon se është. Më poshtë do të zërthej në hollësi disa nga metodat e identifikimit. Të dhënat biometrike, si shenja e gishtërinjve ose njohja e fytyrës mund të përdoren për ta verifikuar identitetin e trashëgimlënësit kur krijohet një testament elektronik. Shumë telefona inteligjentë dhe pajisje, tanimë kanë sisteme të integruara të vërtetimit biometrik që mund të përdoren për këtë qëllim. Konstatimi i autenticitetit me shumë faktorë apo siç njihet në gjuhën angleze *Multi-Factor Authentication* është një mënyrë e fuqishme për ta identifikuar identitetin. Kjo përfshin kombinimin e faktorëve të shumtë të vërtetimit, për shembull diçka që testamentlënësi mban në mend (një fjalëkalim), diçka që posedon (një telefon) dhe diçka që është unike për ta fizikisht (shenjat e gishtërinjve ose tiparet e fytyrës). Duke i përdorur këto mundësi të shumta vërtetimi, siguria rritet shumë. Një metodë tjetër e verifikimit të identitetit është konferenca me video, ku një person i autorizuar ose noter mund të kryejë një video-telefonatë për ta konfirmuar identitetin dhe qëllimin e trashëgimlënësit.

---

<sup>25</sup> Banta, N.M. (no date) *ELECTRONIC WILLS AND DIGITAL ASSETS: REASSESSING FORMALITY IN THE DIGITAL AGE*, pp. 584–587. Gjetur në: <https://www.baylor.edu/law/review/doc.php/350624.pdf> (Aksesi i fundit: 10 October 2023).

- III. Ruajtja e sigurt e dokumentit: Testamentet elektronike duhet të ruhen në mënyrë të sigurt për të parandaluar aksesin dhe ndërhyrjet e paautorizuara. Për këtë qëllim janë marrë në konsideratë zgjidhjet e ruajtjes të bazuara në të ashtuquajturën renë kompjuterike (cloud-storage) dhe në teknologjinë *blockchain*. Në veçanti, *blockchain* ofron një libër (sistem për ruajtjen e të dhënave) transparent dhe të pandryshueshëm që mund të sigurojë një shtresë të shtuar sigurie. Testamenti elektronik dhe çdo e dhënë lidhur me të duhet të jetë e kriptuar. Kriptimi i konverton të dhënat në kod të palexueshëm i cili mund të deshifrohet vetëm me çelësin e duhur të enkriptimit. Kjo siguron që individë të paautorizuar, edhe nëse fitojnë akses në të dhënat e ruajtura, ata nuk mund t'i lexojnë apo t'i përdorin ato.<sup>26</sup>
- IV. Platformat dhe shërbimet në internet: Kompanitë e teknologjisë dhe ofruesit e shërbimeve ligjore kanë filluar të ofrojnë platforma dhe shërbime në internet që u lejojnë individëve të krijojnë më lehtë teste elektronike. Këto platforma shpesh i udhëzojnë përdoruesit përmes procesit të krijimit të vullnetit dhe sigurojnë përputhshmërinë me ligjet lokale. Platformat dhe shërbimet online e bëjnë të lehtë për individët qasjen dhe krijimin e testeve duke qenë komod në shtëpitë e tyre. Përdoruesit zakonisht mund t'u qasen këtyre platformave nëpërmjet internetit ose aplikacioneve celulare. Platformat e tilla janë krijuar për të siguruar përputhshmërinë ligjore, ku ato shpesh përditësohen për t'i pasqyruar ndryshimet në ligjet dhe në rregulloret lokale, duke u ndihmuar përdoruesve të krijojnë teste që janë të vlefshme dhe të zbatueshme. Këto platforma shpesh u lejojnë përdoruesve të caktojnë individë të besuar që mund të kenë akses në testamentin elektronik kur të vij koha që i njëjti të hapet. Përdoruesit gjithashtu mund të kenë mundësinë t'i rishikojnë dhe t'i përditësojnë teste elektronike me ndryshimin e situatave, gjë që mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për të siguruar që vullneti i testmentlënësit të mbetet aktual.

---

<sup>26</sup> *What is Cybersecurity? - Definition from Techopedia* (no date) *Techopedia.com*. Gjetur në: <https://www.techopedia.com/definition/24747/cybersecurity>. (Aksesi i fundit: 24 tetor, 2023)

- V. Noterizimi dhe dëshmitarët: Në shumë juridiksione, testamentet kërkojnë noterizimin ose praninë e dëshmitarëve. Zgjidhjet teknologjike janë zhvilluar për të lehtësuar noterizimin në distancë dhe verifikimin e dëshmitarëve, shpeshherë nëpërmjet mjeteve të video-konferencave. Pas noterizimit, noteri e shton në testament vulën dhe nënshkrimin elektronik të tyre. Kjo shërben si një vërtetim se dokumenti është ekzekutuar në përputhje me kërkesat ligjore. Sa u përket dëshmitarëve, pas nënshkrimit nga ana e tyre, atyre mund t'u kërkohej të japin deklaratë që konfirmon praninë e tyre, identitetin e trashëgimlënësit dhe rrethanat që ndërlidhen me nënshkrimin e testamentit elektronik. Madje në disa raste kërkohej edhe noterizimi i deklaratës së dëshmitarit si një hap shtesë për sigurinë e verifikimit.
- VI. Njohja ndërkombëtare e testamenteve elektronike: Kjo është një çështje ligjore në zhvillim dhe mjaft komplekse. Edhe pse ka një pranim në rritje të testamenteve elektronike në disa juridiksione, njohja ndërkombëtare e tyre përtej kufijve mbetet sfiduese për shkak të dallimeve në sistemet ligjore, në tradita dhe në rregullore. Vlefshmëria e testamenteve është një çështje e të drejtës ndërkombëtare dhe bie nën sovranitetin e çdo vendi të veçantë. Kjo do të thotë se çdo vend i vendos rregullat dhe kërkesat e veta për testamentet, duke përfshirë edhe faktin nëse pranohen testamentet elektronike dhe cilat procedura duhet të ndiqen. Disa organizata dhe organe ndërkombëtare, si Komisioni i Ligjit uniform në Shtetet e Bashkuara, e kanë zhvilluar legjislacionin model për testamentet elektronike me qëllim të promovimit të uniformitetit dhe njohjes ndërkombëtare. Megjithatë, miratimi i modeleve të tilla është një çështje vullnetare dhe shtetet mund të zgjedhin të mos i ndjekin ato. Disa shtete kanë hyrë në marrëveshje ose traktate dypalëshe që e trajtojnë njohjen e testamenteve të huaja, duke i përfshirë edhe testamentet elektronike. Këto marrëveshje mund t'i përcaktojnë kushtet në të cilat pranohen testamentet e huaja.

### 3. Siguria kibernetike mbi testamentet elektronike

Në epokën e sotme digjitale, rritja e testamenteve elektronike e ka revolucionarizuar mënyrën se si individët e planifikojnë shpërndarjen e aseteve të tyre. Megjithëkëtë, me këtë lehtësi lind nevoja për masa të fuqishme të sigurisë kibernetike për ta mbrojtur një informacion të ndjeshëm nga aksesimi, nga shkatërrimi ose nga ndryshimi i paautorizuar. Më poshtë do ta eksploroj rëndësinë e sigurisë kibernetike në testamentet elektronike dhe do t'i theksoj masat që duhet të ndërmerren për ta garantuar integritetin dhe konfidencialitetin e këtyre dokumenteve thelbësore.

### 3.1. Kuptimi i sigurisë kibernetike në testamentet elektronike

Testamentet elektronike u referohen testamenteve që rruhen dhe që ekzekutohen në mënyrë digjitale. Ato përfshijnë përdorimin e pajisjeve elektronike, të rrjeteve dhe softuerin për të krijuar dhe për të shpërndarë dokumente testamentare.<sup>27</sup> Në këtë kontekst, siguria kibernetike përfshin mbrojtjen e të dhënave, të rrjeteve dhe të programeve të lidhura me testamentet elektronike nga aksesimi i paautorizuar, nga ngacmimi ose nga humbja.

### 3.2. Dobësitë dhe rreziqet

Testamentet elektronike janë të ndjeshme ndaj kërcënimeve të ndryshme kibernetike, duke përfshirë hakimin, shkeljet e të dhënave dhe sulmet malware. Këto dobësi mund ta rrezikojnë konfidencialitetin dhe integritetin e testamenteve, duke shkaktuar mosmarrëveshje të mundshme, mashtrime ose pavlefshmëri të qëllimeve të trashëgimlënësive. Masat përkatëse të sigurisë kibernetike janë thelbësore për t'i zbutur këto rreziqe dhe për ta siguruar vlefshmërinë e testamenteve elektronike.

### 3.3. Kriptimi dhe ruajtja e sigurt

Një aspekt thelbësor i sigurisë kibernetike në testamentet elektronike është përdorimi i enkriptimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm. Kriptimi përfshin kodimin e të dhënave sipas një mënyre që mund të arrihet vetëm me një çelës deshifrimi, duke i parandaluar palët e paautorizuara për ta lexuar ose për ta modifikuar përmbajtjen e dokumentit. Për më tepër, sistemet e sigurt të ruajtjes

---

<sup>27</sup> *Cyber Security Essay for Students and Children | 500+ Words Essay (2019) Toppr-guides*. Gjetur në: <https://www.toppr.com/guides/essays/cyber-security-essay/>. (Aksesi i fundit: 24 tetor 2023)

duhet të përdoren për t'i mbrojtur testamentet elektronike nga kërcënimet fizike dhe virtuale.

#### 3.4. Kontrolli i hyrjes dhe vërtetimi

Zbatimi i masave të rrepta të kontrollit të aksesit është i rëndësishëm për t'i parandaluar individët e paautorizuar që të kenë akses në testamentet elektronike. Protokollet e forta të vërtetimit të përdoruesve, të tilla si vërtetimi me shumë faktor<sup>28</sup>, duhet të përdoren për të siguruar se vetëm palët e autorizuara mund ta shohin testamentin ose të bëjnë ndryshime në të. Kjo ndihmon në rruajtjen e integritetit dhe të autenticitetit të dokumentit.

#### 3.5. Përditësimi i rregullt dhe ndërgjegjësimi

Për t'i parandaluar kërcënimet kibernetike të mundshme është e rëndësishme të mbahet i përditësuar softueri dhe sistemet e përdorura për testamentet elektronike. Përditësimi i rregullt ndihmon në adresimin e dobësive të sigurisë të identifikuara nga zhvilluesit e softuerit, duke parandaluar çfarëdo lloj sulmi të mundshëm. Gabimet njerëzore mbeten një nga kontribuuesit më të mëdhenj të shkeljeve kibernetike. Prandaj është thelbësore të edukohen individët e përfshirë në krijimin dhe në ekzekutimin e testamenteve elektronike lidhur me praktikën më të mirë të sigurisë kibernetike. Programet e trajnimit dhe fushatat e ndërgjegjësimit mund të ndihmojnë në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të vigjilencës dhe t'i zvogëlojnë gjasat e shkeljeve të paqëllimshme të të dhënave ose gabimeve të sigurisë.

---

<sup>28</sup> Për detaje rreth vërtetimit me shumë faktorë shiko faqen 31, pika II të këtij dokumenti.

## KAPITULLI I KATËRT

### Testamentet elektronike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Komisioni uniform i ligjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kohët e fundit e ka miratuar Aktin uniform të testamenteve elektronike. Ky ligj do të shërbejë si model për shtetet e tjera që duan ta miratojnë këtë lloj legjislacioni. Disa shtete, si Nevada dhe Indiana, tanimë janë zhytur në lëmin e testamenteve elektronike. Këto dy shtete kanë ligje që i lejojnë testamentet elektronike, kurse Florida dhe Arizona janë në shqyrtim e sipër të një legjislacioni të tillë.

#### 1. Ndikimi i pandemisë Covid-19 te formulimi i testamenteve

Pandemia Covid-19 ka ndikuar në rritjen e konsiderueshme të popullaritetit të testamenteve në internet, të njohura edhe si testamentet elektronike ose digjitale. *Gentreo*, një firmë e planifikimit të pasurive në formë digjitale, me bazë në Boston, arriti një rritje prej 143% të njerëzve që krijojnë teste në internet gjatë fazave të hershme të pandemisë. *Trust&Will*, një firmë tjetër e planifikimit të pasurive në internet, pati një rritje prej 50% të përdoruesve. Frika nga një sëmundje kërcënuese për jetën i shtyri individët të merrnin parasysh trashëgiminë e tyre, kështu që pandemia e përshpejtoi përdorimin e teknologjisë për ta minimizuar nevojën e kontakteve personale për noterizimin e një testamenti. Disa ndërmarrje fillestare të planifikimit të pasurive në internet u përgjigjën sakaq, duke u ofruar përdoruesve një mënyrë të shpejtë dhe ligjrisht të zbatueshme për të hartuar një testament elektronik. Aktualisht, testamentet elektronike janë të ligjshme në 12 shtete të SHBA-së. Në të ardhmen ka gjasa që t'i legalizojnë më shumë shtete.

Testamentet elektronike mund të plotësohen në mënyrë virtuale duke eliminuar nevojën për t'u takuar personalisht me një avokat, me dëshmitarë ose me noter. Kjo

veçori u tregua veçanërisht tërheqëse gjatë pandemisë ku ndërveprimet midis personave ishin të kufizuara.<sup>29</sup>

## 2. Testamentet elektronike në Nevadë

Nevada është i vetmi shtet në SHBA që ka legjislacionin i cili i rregullon në mënyrë specifike testamentet elektronike. Legjislacioni u prezantua për t'u ofruar lehtësi trashëgimlënësve, sidomos atyre që janë "të mprehtë" në teknologji. Ky legjislacion pranon se teknologjia po evoluon vazhdimisht dhe synon t'i përshtatet peizazhit në ndryshim. Me lejimin e testamenteve elektronike, Nevada ofron një qasje moderne për planifikimin e pasurive, duke i mirëpritur përfitimet dhe efikasitetin që mund të sigurojë teknologjia. Legjislacioni pasqyron angazhimin e shtetit për të qenë i përditësuar me përparimet dhe për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve të tij në epokën digjitale.

Për të krijuar një testament elektronik të vlefshëm në Nevadë duhet të plotësohen disa kërkesa. Së pari, ai duhet të krijohet dhe të mbahet si një regjistrim elektronik. Së dyti, ai duhet të përfshijë datën e nënshkrimit dhe një karakteristikë të vërtetimit të trashëgimlënësit, siç është aspekti biologjik unik ose akti fizik që mund të njihet në formë elektronike, siç janë nënshkrimi digjital, gjurmët e gishtërinjve, skanimit i retinës etj.

Përveç kësaj, një testament elektronik në Nevadë duhet të përmbajë nënshkrimin elektronik dhe vulën elektronike të noterit publik që duhet të vihen në prani të trashëgimlënësit kur ata ta nënshkruajnë në mënyrë elektronike testamentin. Ai gjithashtu duhet t'i përmbajë nënshkrimet elektronike të dy ose më shumë dëshmitarëve të cilët e nënshkruajnë dokumentin në prani të trashëgimlënësit, përderisa ky i fundit e nënshkruan testamentin në formë elektronike.

Dispozitat ligjore të Nevadës dhe UEWA (United Electronic Wills Act) japin leje që procesi i dëshmisë të vëzhgohet nga distanca. Njëherazi, ligji i testamentit elektronik në Nevadë e shtjellon termin "prani" duke përfshirë individët me vendndodhje fizike

---

<sup>29</sup> *Covid-19 Made Us Confront Death. Online Wills Spiked. (2023) Barron's.* Barron's. Gjetur në: <https://www.barrons.com/articles/pandemic-online-wills-51675125583> (Aksesi i fundit: 24 tetor 2023).



të ndryshme, të cilët mund të përfshihen në komunikim duke përdorur mjete audio-vizuale. Po kështu, UEWA njeh raste ku trashëgimlënësi dhe dëshmitarët marrin pjesë me prezencë elektronike. Ky atribut ofron një mundësi të sofistikuar për t'i mbështetur masat mbrojtëse që ndërlidhen me kërkesën për dëshmi. Kjo është një mënyrë shumë e përshtatshme për përpilimin e një testamenti në gjendje të izoluar.<sup>30</sup>

Për t'u konsideruar i vlefshëm, testamenti elektronik duhet të përmbajë një deklaratë nën betim nga dëshmitarët ku vërtetohet se ata kanë qenë pjesë e nënshkrimit të testamentit nga trashëgimlënësi. Përveç kësaj, për testamentin elektronik duhet të caktohet një kujdestar i kualifikuar për ta ruajtur regjistrimin elektronik të testamentit dhe duhet të qëndrojë nën kujdestarinë e tij gjatë gjithë kohës, derisa testamenti elektronik të jepet për verifikim. Kujdestari i tillë duhet të japë deklaratë me shkrim me të cilën në mënyrë pozitive pranon të shërbejë si kujdestar i kualifikuar i testamentit elektronik.<sup>31</sup>

Përgjithësisht, këto kërkesa e theksojnë rëndësinë e sigurimit të autenticitetit dhe të vlefshmërisë së testamenteve elektronike në Nevadë, duke u ofruar individëve me njohuri teknologjike një mjet të sigurt dhe ligjërish të pranuar për planifikimin e pasurive së tyre pas vdekjes.<sup>32</sup>

### 3. Testamentet elektronike në Ohajo

Kuadri ligjor i Ohajos, sikundër përshkruhet në seksionin 2107.03 të Ligjit të kodifikuar të Ohajos, i rregullon metodat e lejuara të krijimit të testamenteve. Statuti përcakton se termi “*me shkrim*” i përfshin testamentet tradicionalisht të shkruara me dorë si dhe

---

<sup>30</sup> Horton, D. and Weisbord, R.K. (2020) *COVID-19 and Formal Wills*. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3572097](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3572097), fq. 26 (Aksesi i fundit: 24 October 2023).

<sup>31</sup> NRS: CHAPTER 133 - WILLS (no date) [www.leg.state.nv.us](http://www.leg.state.nv.us). Gjetur në: <https://www.leg.state.nv.us/nrs/nrs-133.html>, NRS 133.300, (Aksesi i fundit: 20 October 2023).

<sup>32</sup> How to Create an Electronic Will in Nevada (no date) Trust & Will. Gjetur në: <https://trustandwill.com/learn/electronic-will-in-nevada> (Aksesi i fundit: 20 October 2023).

ato të shkruara në formë digjitale. Vlen të përmendet se në praktikën bashkëkohore, shumica dërrmuese e testamenteve janë të shkruara në formën digjitale.<sup>33</sup>

Për më tepër, statuti e sqaron nocionin e të qenit “*në prani të vetëdijshme të trashëgimlënësit*”. Ky koncept i përket një skenari në të cilin një person nënshkruan një testament në emër të trashëgimlënësit, zakonisht për shkak të paftësisë fizike të tij. Në raste të tilla, statuti sqaron se “*prania e vetëdijshme*” nënkupton të qenit mjaftueshëm afër në mënyrë që testamentlënësi të mundë të të shohë, të të dëgjojë ose të të prekë, por përjashtohet mundësia e shikimit ose e dëgjimit përmes metodave telefonike, elektronike apo formave të ngjashme. Megjithëse gjuha parësore e statutit i referohet kryesisht personit që e nënshkruan testamentin në emër të trashëgimlënësit, është e mundur që kjo ide të zbatohet edhe te dëshmitarët të cilët nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm gjatë nënshkrimit, por procesin e kanë vëzhguar në mënyrë elektronike, si për shembull përmes platformave siç është *skype*.

Sistemi ligjor i Ohajos ofron ndihmë për të parë se si të trajtohen testamentet elektronike. Ka pasur një rast në Ohajo kur një testament është përpiluar në një tablet Samsung Galaxy duke përdorur një stilolaps të veçantë. Ky testament është pranuar si i vlefshëm në qarkun e Lorain në bazë të ligjit të “*gabimit të padëmshëm*” të Ohajos, edhe pse testamenti nuk kishte deklaratë të nevojshme me shkrim siç e kërkon ligji. Në këtë rast, edhe trashëgimlënësi edhe dëshmitari testamentin e kanë nënshkruar në tabletin e tij me lapsin e posaçëm të tabletit. Ende nuk duhet saktë nëse në këtë rast testamenti do të pranohej, po qe se trashëgimlënësi dhe dëshmitari do ta kishin nënshkruar testamentin në formë digjitale dhe jo me dorë. Vlen të theksohet se Akti uniform i transmetimeve elektronike (UETA) i lejon nënshkrimet digjitale nëpër kontrata, por kjo nuk zbatohet edhe për testamentet.<sup>34</sup>

---

<sup>33</sup> 2012 Ohio Revised Code :: Title [21] XXI COURTS - PROBATE - JUVENILE :: Chapter 2107 - WILLS :: Section 2107.03 - Method of making will. (no date) *Justia Law*. Gjetur në: <https://law.justia.com/codes/ohio/2012/title-21/chapter-2107/section-2107.03/> (Aksesi i fundit: 25 tetor 2023).

<sup>34</sup> latte (2019) *Electronic Wills in Ohio - Gudorf Law, Gudorf Law Group, LLC*. Gjetur në: <https://www.daytonestateplanninglaw.com/electronic-wills-ohio/> (Aksesi i fundit: 25 tetor 2023).

#### 4. Testamentet elektronike në Floridë

Florida gjithashtu e lejon krijimin e testamenteve elektronike dhe sugjerohet që kjo të bëhet nëpërmjet shërbimeve *online* që ofrohen nga kompani me reputacion. Testamentet elektronike në Floridë rregullohen ligjërisht në *Florida House Bill 483*.<sup>35</sup>

Shteti i Floridës, përdorimin e testamenteve elektronike e lejoi zyrtarisht në qershor të vitit 2020. Testamentet elektronike janë të krijuara, të nënshkruara, të dëshmuara dhe të ruajtura në internet tërësisht në mënyrë digjitale. Si rrjedhojë, nuk ka nevojë të bëhen kopje të testamentit të nënshkruar fizikisht. Kjo bëhet e mundur pasi që autoritetet shtetërore i njohin nënshkrimet digjitale për vërtetimin e një testamenti.

Përpara se testamentet elektronike të fitonin miratim ligjor, testamentet tradicionale duhej të ishin në formë të shkruar. Individit që bënte testament duhej të ishte i shëndoshë mendërisht dhe ta nënshkruante testamentin fizikisht në prani të dy dëshmitarëve. Dëshmitarët ishin gjithashtu të detyruar ta nënshkruanin testamentin fizikisht në prani të trashëgimlënësit dhe të njëri-tjetrit.

Duke marrë parasysh faktin se shumë shtete i njohin testamentet elektronike, secili prej tyre ka kërkesa të veçanta sa i përket plotfuqishmërisë së tyre. Më poshtë do t'i cekim disa prej kërkesave që duhet të plotësohen, në mënyrë që testamenti elektronik të jetë i vlefshëm në Floridë:

- Trashëgimlënësi duhet të ketë arritur moshën madhore, që është 18 vjeç ose të jetë i mitur i emancipuar.
- Trashëgimlënësi duhet të ketë aftësi testamentare, që do të thotë të jetë në mendje të shëndoshë dhe të jetë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe për pronën që posedon.
- Trashëgimlënësi duhet ta nënshkruajë testamentin në fund. Këtu përfshihet edhe mundësia për nënshkrim elektronik.

---

<sup>35</sup> *House Bill 483 (2021) - The Florida Senate* (no date) [www.flsenate.gov](http://www.flsenate.gov). Gjetur në: <https://www.flsenate.gov/Session/Bill/2021/483> (Aksesi i fundit: 25 tetor 2023).

- Së paku dy dëshmitarë duhet të jenë prezentë në momentin kur trashëgimlënësi e nënshkruan testamentin e tij. Kjo mund të bëhet edhe nëpërmjet video konferencave.
- Dëshmitarët gjithashtu duhet ta nënshkruajnë testamentin dhe këtë duhet ta bëjnë në prani të trashëgimlënësit. Ky proces mund të kryhet në formë elektronike.
- Palët e lartpërmendura duhet të nënshkruajnë nën mbikëqyrjen e një noteri të trajnuar dhe të certifikuar, *online*.
- Në fund të krejt procesit, testamenti i dorëzohet një kujdestari të kualifikuar për mbikëqyrje.

Për t'u konsideruar i vlefshëm, zakonisht nuk ka nevojë që testamenti të noterizohet. Në fakt, që nga maji i vitit 2021, vetëm Luiziana kërkon që testamenti të noterizohet. Noterizimi i testamentit përgjithësisht është një mënyrë që e përshpejton procedurën e verifikimit të originalitetit të tij. Megjithatë, kërkesat ndryshojnë kur bëhet fjalë për testamente elektronike. Në Floridë një testament elektronik për t'u konsideruar i vlefshëm duhet të kalojë nëpër procedurën e noterizimit. Ashtu siç u përmend edhe më sipër, një noter online i certifikuar duhet ta mbikëqyr tërë procesin e përpilimit të testamentit. Gjithashtu detyrë e tij është që ta vërtetojë identitetin e të gjitha palëve të përfshira (të testamen lënësit dhe të dëshmitarëve).

Një kërkesë tjetër thelbësore për testamentet elektronike është përfshirja e një kujdestari të kualifikuar. Ky subjekt mund të jetë një biznes i regjistruar ose një banor me vendbanim kryesor në Floridë. Roli i tyre është të kenë sistem për ruajtjen dhe për menaxhimin e të dhënave elektronike, duke përfshirë këtu edhe testamentet. Në këtë rast, testamenti duhet të ruhet nga kujdestari, ndërsa për ta siguruar vlefshmërinë e tij, ai duhet të shoqërohet me regjistrimin audio-vizual të procesit të noterizimit.<sup>36</sup>

---

<sup>36</sup> *How to Create an Electronic Will in Florida* (no date) *Trust & Will*. Gjetur në: <https://trustandwill.com/learn/electronic-will-in-florida> (Aksesi i fundit: 25 tetor 2023).

## 5. Testamentet elektronike në Virxhinia

Në fillim të vitit 2021 Virxhinia e miratoi Ligjin për njohjen e testamenteve elektronike, për sa kohë që plotësohen kërkesat e përcaktuara me ligj. Rregullat e planifikimit të ndarjes së pasurive pas vdekjes janë specifike në çdo shtet, ndonëse procesi është mjaft i ngjashëm në të gjithë vendin. Tradicionalisht, testamentet janë përgatitur me dorë, duke e kërkuar nënshkrimin e trashëgimlënësit në prani të dy dëshmitarëve. Me prezantimin e Aktit uniform të testamenteve elektronike, tani trashëgimlënësi ka mundësi ta ekzekutojë testamentin në mënyrë digjitale, në prani të dy dëshmitarëve ose të noterit publik, nëpërmjet metodave elektronike siç janë video konferencat, ndërkohë që ata i vënë nënshkrimet e tyre.

Ndikim të madh në njohjen e testamenteve elektronike në Virxhinia ka pasur edhe pandemia e Covid-19. Edhe pas lehtësimit të masave të distancës sociale, një numër i konsiderueshëm individësh vazhdojnë t'i shfrytëzojnë lehtësitë dhe aksesin e ekzekutimit të testamenteve nëpërmjet videove ose mjeteve të tjera elektronike, përballë nënshkrimeve që jepen personalisht në zyrat e avokatëve. Ky trend është veçanërisht i theksuar te gjeneratat më të reja të cilat shfaqin një preferencë të madhe për qasjet digjitale dhe virtuale kur bëhet fjalë për trajtimin e dokumenteve ligjore. Statistikat e periudhës së viteve 2020-2021 në Virxhinia dëshmojnë për një rritje të konsiderueshme të përqindjes së individëve të moshës 18 deri 34 vjeç që posedojnë testament. Me fjalë të tjera, kemi një rritje prej 16.4 për qind në 27 për qind.

Një testament në Virxhinia, si ai elektronik, ashtu edhe ai tradicional, për t'u konsideruar ligjor i vlefshëm duhet tu përmbahet kushteve të mëposhtme:

- Testamentlënësi duhet të ketë mbushur së paku 18 vjeç;
- Testamenti duhet të dokumentohet me shkrim, ngase testamenti me gojë nuk pranohet;
- Testamenti duhet të përmbajë nënshkrimin e trashëgimlënësit;
- Testamentlënësi duhet ta nënshkruajë testamentin në prani të dy dëshmitarëve;

- Megjithëse nuk është e detyrueshme për një kopje fizike të testamentit, nevojitet përfshirja e noterit, po qe se testamenti krijohet në përputhje me legjislacionin e ri të Virxhinias. Përgjithësisht, është mirë të nënshkruhet në prani të noterit i cili mund ta verifikojë në mënyrë të pavarur moshën dhe identitetin e trashëgimlënësit dhe të dëshmitarëve;

Sipas ligjit të Virxhinias, një testament i ekzekutuar në mënyrë elektronike duhet t'i plotësojë kërkesat e lartpërmendura dhe të pranohet edhe nga trashëgimlënësi si dhe nga dëshmitarët, në praninë fizike ose elektronike të një noteri publik. Po qe se është e nevojshme, noteri mund të shërbejë si njëri prej dy dëshmitarëve të nevojshëm.<sup>37</sup>

Disa rregulla të tjera për testamentet elektronike në Virxhinia janë:

- Nënshkrimi i testamentit nga ana e trashëgimlënësit të bëhet në prani të dy dëshmitarëve, procedurë kjo që mund të zbatohet tërësisht në formë elektronike.
- Dy dëshmitarët duhet ta nënshkruajnë gjithashtu dokumentin e testamentit derisa është i pranishëm edhe trashëgimlënësi.
- Trashëgimlënësi duhet të bashkëngjitë një deklaratë të noterizuar për të krijuar një testament të vërtetuar nga vetë ai.<sup>38</sup>

## 6. Testamentet elektronike në Arizonë

Shteti i Arizonës i ka pranuar testamentet elektronike dhe i konsideron ato si dokumente ligjërish të pranueshme. Ky ndryshim i rëndësishëm ndodhi në vitin 2018 kur Arizona u bë shteti i tretë me radhë që i pranoi testamentet e tilla, duke ndjekur hapat e Nevadës dhe të Indianës. Është e rëndësishme të theksohet se rregulloret që i rregullojnë testamentet elektronike janë duke u përhapur në të gjitha shtetet. Aktualisht, vetëm disa shtete të përzgjedhura e pranojnë vlefshmërinë e testeveve elektronike, kurse kërkesat specifike mund të ndryshojnë në shteti në

<sup>37</sup> *How to Execute Electronic Wills in Virginia* (no date). Gjetur në: <https://www.novaestatelawyers.com/electronic-wills-in-virginia/> (Aksesi i fundit: 26 tetor 2023).

<sup>38</sup> *Create Your Online Will in Virginia* (no date) *Trust & Will*. Gjetur në: <https://trustandwill.com/learn/virginia-online-will> (Aksesi i fundit: 26 tetor 2023).

shtet. Disa shtete kanë miratuar një qasje të standardizuar të quajtur Akti uniform i testamenteve elektronike (UEWA) që është zhvilluar nga Komisioni uniform i ligjeve. Ky kuadër synon t'i harmonizojë rregullat dhe kushtet për testamentet elektronike ndërmjet shteteve të ndryshme. Megjithatë, përderisa disa shtete e kanë miratuar UEWA-në, shtete të tjera kanë krijuar grupe të veçanta ligjesh dhe parakushtesh për plotfuqishmërinë e testamenteve elektronike.<sup>39</sup>

Testamenti elektronik në Arizonë është i rregulluar me Kodin e verifikimit që në gjuhën angleze quhet *Probate Code*. Kodi i verifikimit i Arizonës i pasqyron kushtet specifike që e bëjnë një testament elektronik ligjërish të vlefshëm:

- **Formati elektronik:** Testamenti elektronik duhet të hartohet dhe të rruhet si një regjistrim digjital.
- **Nënshkrimi elektronik i testamentlënësit:** Testamenti duhet ta ketë nënshkrimin elektronik të trashëgimlënësit. Përveç nga testamentlënësi, ky nënshkrim mund të kryhet edhe nga një person tjetër, me kusht që dokumenti të nënshkruhet në prani të trashëgimlënësit dhe nën drejtimin e tij.
- **Nënshkrimet e dëshmitarëve:** Testamenti duhet të përmbajë nënshkrimet e të paktën dy dëshmitarëve. Në momentin kur testamentin e nënshkruajnë në mënyrë elektronike, këta të fundit duhet të jenë fizikisht të pranishëm me trashëgimlënësin.
- **Data e nënshkrimit:** Nënshkrimet elektronike të trashëgimlënësit dhe të dëshmitarëve duhet të jenë të shoqëruara me datën se kur janë nënshkruar.
- **Dokumentacioni i identifikimit:** Testamentlënësi duhet të përfshijë kopjen e vlefshme të kartës së identitetit të lëshuar nga qeveria në kohën e realizimit të testamentit.<sup>40</sup>

Të gjitha këto përcaktime përbëjnë kërkesat për ligjshmërinë e një testamenti elektronik sipas Kodit të verifikimit të Arizonës.

---

<sup>39</sup> *How to Create an Electronic Will in Arizona* (no date) *Trust & Will*. Gjetur në: <https://trustandwill.com/learn/electronic-will-in-arizona> (Aksesi i fundit: 26 tetor 2023).

<sup>40</sup> *View Document* (no date) [www.azleg.gov](http://www.azleg.gov). Gjetur në: <https://www.azleg.gov/viewdocument/?docName=https://www.azleg.gov/ars/14/02518.htm> (Aksesi i fundit: 26 tetor 2023).

## 7. Avantazhet dhe disavantazhet e testamenteve elektronike

Testamentet elektronike i kanë përparësitë, por edhe të metat e tyre. Siç dihet tanimë, në shumë vende të botës rritet vazhdimisht potenciali për ta shprehur vullnetin, për ta nënshkruar në formë elektronike dhe për ta ruajtur të sigurt një testament elektronik. Akti uniform i testamenteve elektronike, i ratifikuar nga Komisioni uniform i ligjeve u ofron avokatëve dhe trashëgimlënësve mundësinë për krijimin e testamenteve elektronike dhe për ruajtjen e tyre në platforma digjitale, siç është Cloud.

Kryesisht, procesi vijon si më poshtë: trashëgimlënësi e shpreh vullnetin e tij të fundit në mënyrë digjitale dhe ia transmeton atë një noteri online, i cili më pas zhvillon një video-konferencë me trashëgimlënësin. Varësisht prej legjislacioneve mund të kërkohej edhe prania digjitale e dëshmitarëve. Gjatë takimit virtual, noteri bën pyetje dhe e noterizon dokumentin. Pas kësaj, testamenti i kompletuar ruhet në mënyrë të sigurt në internet.

Janë disa arsye që i motivon individët për përpilimin e testamenteve elektronike, si: Ndryshe nga testamentet tradicionale, versioni elektronik mund të ruhet më lehtë, kështu që shmangjet mundësia për humbjen apo dëmtimin e tij. Përveç komoditetit që të jep krijimi i një testamenti elektronik, pavarësisht nga fakti se ndodhesh, sidomos për personat që nuk kanë mundësi për të lëvizur. Është proces i lehtë edhe shpërndarja e dokumentit nga noteri, nga avokati dhe nga palë të tjera përkatëse, duke promovuar kështu shpërndarjen e aseteve në kohë dhe në mënyrë efikase.

Por duhet thënë se testamentet elektronike ngërthejnë në vete edhe mangësi. Një prej të metave të tyre është fakti se jo çdo shtet i pranon testamentet e tilla. Lidhur me trashëgiminë me anë të testamentit elektronik, trashëgimlënësi duhet të ketë informata të duhura për legjislacionin e vendit të tij. Një pikë tjetër me rëndësi është fakti se gjatë përpilimit të testamenteve të tyre, testamentlënësit mund të harrojnë ndonjë detaj të rëndësishëm. Përkundër faktit se testamentet elektronike mund të përditësohen apo të revokohen, është mirë që të merren njoftime nga ndonjë person përkatës, me përvojë në fushën e testamenteve elektronike.



Testamentet elektronike mund të jenë të ndjeshme ndaj mashtrimit ose lajthimit po qese gjatë procesit të noterizimit online nuk vërtetohen me saktësi identiteti dhe qëllimi i trashëgimlënësit. Në këtë rast noterët online duhet të jenë tejet të kujdesshëm.

## KAPITULLI I PESTË

### Raste studimi

#### 1. Rasti Macdonald v. Master

Në disa shtete, gjykatat tashmë kanë filluar të ndihmojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e testamenteve elektronike. Interesant në këtë drejtim është edhe rasti i njohur si MacDonald v. the Master ku gjykata duhej të vendoste nëse do të pranonte ose jo një testament elektronik që ishte regjistruar dhe që ruhej në kompjuterin e trashëgimlënësit. Ky rast paraqet një pikë kryesore në zhvillimin e testamenteve elektronike, duke nënvizuar sfidat me të cilat përballet sistemi ligjor kur e trajton këtë formë testamentare moderne.

Testatori, Malcolm Scott Macdonald më 14 dhjetor të vitit 2000 ka kryer vetëvrasje duke lënë në tryezën afër krevatit katër dokumente të shkruara me dorë të vet. Një nga këto katër dokumente përmbante një deklaratë në të cilën ai i kishte shkruar të dhënat e tij personale, si emir, mbiemri, numri i identifikimit si dhe një deklaratë se në kompjuterin e tij personal të tipit IBM kishte lënë një testament duke e specifikuar edhe dosjen se ku e kishte ruajtur atë. Testamentlënësi në fjalë ishte specialist i lartë i teknologjisë informative në një degë lokale të IBM-së. Bashkëpunëtorët e tij e kanë marrë deklaratën e shkruar nga trashëgimlënësi, e kanë aksesuar dosjen e përcaktuar dhe e kanë printuar testamentin. Më pas, një kopje të të njëjtit ia kanë dorëzuar bashkëshortes së testamentlënësit.

Gjykata fillimisht nuk ka qenë e gatshme që ta pranonte testamentin si të vlefshëm sepse nuk i plotësonte kriteret ligjore për formën e testamentit sipas ligjit të Afrikës së Jugut ku sipas të njëjtit kërkohet që një testament të ketë një version të shkruar, i cili të jetë i vërtetuar nga dy dëshmitarë, duke pasur në çdo faqe edhe inicialet e trashëgimtarit.

Megjithatë, gjykata në këtë rast nuk nguli këmbë për zbatimin e përpiktë të këtij ligji. Kjo shmangie nga respektimi i rigoroz justifikohet me faktin se respektimi i rreptë i formës tradicionale do të binte ndesh me qëllimin kryesor të ligjit, d.m.th. të mos

shpallet e pavlefshme shprehja përfundimtare e vullnetit, për shkak të mospërputhjes formale.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të rrethanave të çështjes, gjykata përcaktoi se trashëgimlënësi kishte synuar vërtet që deklarata e tij digjitale të shërbente si testament dhe si testament i tij i fundit. Ky vendim u përforcua nga fakti se dokumenti nuk paraqiste një draft fillestar, por përfaqësonte qartas versionin përfundimtar të testamentit të trashëgimlënësit.

Rasti MacDonald kundër Master dëshmon për natyrën dinamike të praktikave bashkëkohore të testamentit dhe për reagimet ligjore në zhvillim ndaj testeve elektronike. Ndërsa sistemi ligjor përballë me implikimet e testeve elektronike, ky rast është një precedent konkret në krijimin e peizazhit ligjor dhe në harmonizimin e kërkesave ligjore tradicionale me epokën digjitale.<sup>41</sup>

Përfundime: Ky rast lundron në terrenin e ndërlikuar ku normat tradicionale të testamentit plotësojnë sfidat e paraqitura nga testet elektronike. Në këtë rast, gjykata u përball me dilemën e vërtetimit të një testi elektronik të ruajtur në kompjuterin e të ndjerit, duke shmangur kriteret e përcaktuara ligjore që kërkonin një version me shkrim me vërtetime specifike.

Largimi i gjykatës nga respektimi i rreptë i formave tradicionale pasqyron një njohje të dinamikës në zhvillim në shprehjet testamentare, duke shënuar një moment kyç në formësimin e precedentëve ligjorë për testet elektronike dhe harmonizimin e kërkesave ligjore tradicionale me epokën digjitale.

## 2. Rasti i Taylor v. Holt

Steve Godfrey kishte krijuar një testament duke përdorur kompjuterin e tij dhe në fund e kishte nënshkruar të njëjtin në mënyrë elektronike. Ai gjithashtu kishte kërkuar pjesëmarrjen e dy fqinjëve të cilët e morën rolin si dëshmitarë të testamentit. Tragjikisht, Godfrey ndërroi jetë rreth një javë pas përpilimit të testamentit. E dashura

---

<sup>41</sup> Nasufi, I. and Bexheti, V. (2021) *Testamenti Elektronik*, fq.13-14.

e tij Doris Holt e kishte nisur procesin e njohjes zyrtare të testamentit, ku menjëherë pas saj, motra e trashëgimlënësit Donna Godfrey Taylor i ndërmori veprimet ligjore duke paraqitur një ankesë. Një nga argumentet kryesore në ankesën e saj ishte se testamentit i mungonte një nënshkrim fizik dhe ajo pohoi se Godfrey kishte vdekur pa lënë një testament të vlefshëm. Vlen të ceket se Donna Godfrey do të ishte trashëgimtarja e vetme sipas ligjit të Tenesit, sikur trashëgimlënësi të mos kishte testament.

Pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës, gjykata e miratoi kërkesën e të pandehurës Doris Holt për gjykim të shkurtuar. Ky vendim u arsyetua pasi u konstatua se nuk kishte mosmarrëveshje të rëndësishme lidhur me faktet thelbësore dhe se të gjitha kërkesat ligjore për krijimin dhe dëshmimin e saktë të testamentit ishin përmbushur. Si rezultat, paditësja Donna Godfrey Taylor, kundër vendimit të gjykatës paraqiti ankesë.<sup>42</sup>

Përfundime: Në rastin e testamentit elektronik të Steve Godfrey, vendimi i gjykatës që favorizonte Doris Holt, vuri në dukje pranimin e nënshkrimeve elektronike, duke theksuar plotësimin e kërkesave ligjore. Apeli i Donna Godfrey Taylor prezanton një kapitull të ri në dialogun e vazhdueshëm rreth përshtatjes së kriterëve ligjore tradicionale me praktikën e testamentit digjital.

Ky rast shërben si një katalizator për diskutimet mbi formimin e ligjeve që harmonizohen me peisazhin dinamik të testamentëve elektronike, duke ofruar njohuri mbi përgjigjen e sistemit ligjor ndaj teknologjive në zhvillim në ligjin e trashëgimisë.

### 3. Akti uniform i testamentëve elektronike

Akti uniform i testamentëve elektronike është një legjislacion novator që është miratuar në shumë shtete të Shteteve të Bashkuara për të adresuar kërkesën në rritje për testamente elektronike. Ky akt i zhvilluar nga Komisioni uniform i ligjeve njihet nevojën për ta përshtatur procesin tradicional të ekzekutimit të testamentëve me

---

<sup>42</sup> *Taylor v. Holt (2003)* (no date) *Findlaw*. Gjetur në: <https://caselaw.findlaw.com/court/tn-court-of-appeals/1109985.html> (Aksesi i fundit: 27 October 2023).

epokën digjitale, ku ofron një strukturë gjithëpërfshirëse për krijimin, për ekzekutimin dhe për njohjen e testamenteve elektronike, duke ofruar siguri dhe lehtësi për trashëgimlënësit dhe për trashëgimtarët.

Në një kohë kur teknologjia digjitale e ka transformuar pothuajse çdo aspekt të jetës tonë, fusha e jurisprudencës nuk mund të mbetet jashtë këtij trendi. Testamentet tradicionale që zakonisht hartohen në letër dhe nënshkruhen fizikisht në prani të dëshmitarëve, kishin nevojë për një përditësim.

Disa nga dispozitat kryesore të Aktit uniform të testamenteve elektronike:

- Përkufizimi dhe vlefshmëria e testamenteve elektronike: Akti i testamenteve elektronike përcakton përkufizimin e këtij lloji të testamentit si një dokument që krijohet, rruhet dhe ekzekutohet në një format elektronik ( *UEWA, Section 2, paragrafi 3*). Akti gjithashtu i përshkruan kërkesat për vlefshmërinë e testamenteve elektronike, duke përfshirë edhe faktin se dokumenti duhet të jetë në një format të lexueshëm, të nënshkruar nga trashëgimlënësi dhe të dëshmuar nga të paktën dy dëshmitarë. Përveç kësaj, akti gjithashtu e trajton çështjen e revokimit, duke siguruar që testamentet elektronike mund të revokohen ose të modifikohen sikurse edhe testamentet tradicionale. (*UEWA, Section 7. Revocation*)
- Autenticiteti dhe masat e sigurisë: Për të garantuar integritetin dhe origjinalitetin e testamenteve elektronike, Akti mandaton përdorimin e masave të vërtetimit dhe sigurisë siç janë nënshkrimet digjitale, enkriptimi dhe vulosja kohore, për të parandaluar ngacmimet ose aksesin e paautorizuar.
- Ekzekutimi elektronik: Ky akt lejon krijimin e testamenteve elektronike në formë digjitale. Testamentlënësi mund të përdorë kompjuter, tablet ose pajisje të tjera elektronike për të hartuar testamentin e tij, duke e reduktuar kësisoj përdorimin e letrës për përpilimin e testamentit. (*UEWA, Section 5. Execution of electronic will*)

Përderisa testamentet elektronike ofrojnë përfitime të shumta, shqetësimet lidhur me sigurinë dhe me parandalimin e mashtrimit vazhdojnë. Mbrojtja nga aksesin e paautorizuar, nga ngacmimi ose nga detyrimi është thelbësore për ruajtjen e

integritetit të vullneteve elektronike. Akti uniform i testamenteve elektronike i trajton këto shqetësime duke përfshirë masat e vërtetimit, por vigjilenca e vazhdueshme dhe përparimet teknologjike janë të nevojshme për t'u bërë ballë kërcënimeve të mundshme.

Miratimi i këtij Akti ndryshon nga shteti në shtet, ku disa juridiksione përfaqësojnë vullnetet elektronike, ndërsa të tjerat mbeten të kujdesshme ose u bëjnë rezistencë ndryshimeve. Kjo mungesë uniformiteti mund të paraqesë sfida për individët e pasur në vende të ndryshme ose për ata që zhvendosen shpesh nga një shtet në tjetrin.

Akti uniform i testamenteve elektronike e ka hapur rrugën për modernizimin e ligjeve të testamentit dhe përshtatjen e epokës digjitale. Duke ofruar një kornizë të qartë për krijimin, për ekzekutimin dhe për administrimin e testamenteve elektronike, akti i adreson nevojat në zhvillim të individëve në një botë gjithnjë më digjitale. Ndërsa sfidat vazhdojnë, Akti paraqet një hap të rëndësishëm drejt garantimit të aksesit, të sigurisë dhe të efikasitetit në fushën e planifikimit të pasurive. Përderisa teknologjia vazhdon të përparojë, kur është fjala për ligjin testamentar, është thelbësore që shtetet ta përshtatin dhe ta miratojnë legjislacionin në përputhje me ndryshimet.<sup>43</sup>

---

<sup>43</sup> *Electronic wills act (2021) Electronic Wills Act - Uniform Law Commission*. Gjetur në: <https://www.uniformlaws.org/viewdocument/final-act-60?CommunityKey=a0a16f19-97a8-4f86-afc1-b1c0e051fc71&tab=librarydocuments> (Aksesi I fundit: 30 tetor 2023).

## REKOMANDIME

- Kushtet thelbësore për formalitetet e testamenteve të zbuten, duke i pranuar testamentet elektronike si të vlefshme. Në këtë mënyrë do t'u ofrohet qytetarëve më shumë zgjidhje të përshtatshme për shpërndarjen e aseteve të tyre me anë të testamentit. Kur themi kushtet thelbësore, përfshihen nënshkrimi elektronik i testamentlënësit dhe i dëshmitarëve, noterizimi i testamenteve dhe krijimi i databazave për ruajtjen e sigurt të testamenteve elektronike.
- Noterët të licencohen për të ushtruar punën e tyre në formë digjitale dhe të mundë noterizimin e testamenteve ta kryejnë nëpërmjet video-konferencave me palët përkatëse. Shteti gjithashtu duhet ta marrë në konsideratë miratimin e dispozitave ligjore për njohjen e video-konferencave me dëshmitarët dhe me testamentlënësin, me qëllim të vërtetimit të identitetit të testamentlënësit si dhe të qëllimit të tij.
- Të jetësohen kërkesat ligjore për nënshkrime elektronike duke i plotësuar standardet specifike të sigurisë dhe protokollet e vërtetimit.
- Sa i përket ruajtjes së testamenteve elektronike në vendin tonë, do të ishte shumë efikas krijimi i një serveri Cloud ku të gjithë noterët të mundë t'i ruajnë në mënyrë të sigurt testamentet elektronike të klientëve të tyre, me anë të sigurimit me shumë faktorë, duke u lejuar akses vetëm personave të caktuar. Gjithashtu, të merret parasysh vendosja e proceseve të vazhdueshme të monitorimit dhe të rishikimit për të vlerësuar efektivitetin dhe sigurinë e testamenteve elektronike për t'iu përshtatur teknologjisë që ndryshon dhe për t'i adresuar sfidat e mundshme.
- UEWA apo Akti uniform i testamenteve elektronike qëndron fortë si një model për të gjitha shtetet që janë të gatshme t'i implementojnë në legjislacionet e tyre testamentet elektronike.
- Të ofrohet edukim dhe trajnime për profesionistët ligjorë, siç janë noterët, si dhe për qytetarët lidhur me ekzekutimin e duhur të testamenteve elektronike. Shteti duhet të tregojë konsideratë ndaj kërkesave për certifikimin të noterëve

dhe profesionistëve të tjerë ligjorë të përfshirë në ekzekutimin dhe në vërtetimin e testamenteve elektronike.

- Të promovohet njohja dhe pranimi ndërkombëtar i testamenteve elektronike për të akomoduar individë me pasuri në shtete të ndryshme, sidomos me vendet fqinje të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Inkurajimi i zhvillimit të marrëveshjeve apo të konventave ndërkombëtare që i njohin dhe i zbatojnë vullnetet elektronike përtej kufijve.

Reformat ligjore duhet të përputhen me ndryshimet teknologjike në zhvillim, duke i dhënë përparësi sigurisë, autenticitetit dhe drejtësisë në ekzekutimin dhe në verifikimin e testamenteve elektronike. Bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve ligjorë, ligjvënësve dhe ekspertëve është thelbësor për ta zbatuar me sukses këtë tranzicion dhe për t'u ofruar qytetarëve opsione efektive dhe të sigurta të planifikimit të ndarjes së pasurive të tyre.



## BIBLIOGRAFIA

Libra, artikuj, rishikime të ligjeve:

1. Micković, D. and Ristov, A. (2020) 'Закон', in *Nasledno Pravo*. Skopje: Univerzitet 'Sv. Kiril i Metodij'.
2. Podvorica, H. (2010) *E drejta trashëgimore*. Prishtinë.
3. Załucki, M. (2021) Solving the 'Problem' of Wills Formalities in the Modern Post-Pandemic Society: Can the Endless Discussion Conclude? pdf. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3946460](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3946460)
4. Metaj-Stojanova, A. (2022) 'Zotësia për të përpiluar testament', në *Të drejtat e fëmijëve: Sfidat dhe perspektivat e reja*. Tetovë, Maqedonia e Veriut.
5. Ajdini, Miranda.(2022). Liria e disponimit me testament në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Konflikti në mes normativës dhe praktikës (Punim masteri).
6. Nasufi, I. and Bexheti, V. (2021) *Testamenti Elektronik*
7. Hlr (2023) What is an 'electronic will'?, *Harvard Law Review*. Gjetur në: <https://harvardlawreview.org/print/vol-131/what-is-an-electronic-will/>
8. Beyer, G.W. and Hargrove, C.G. (2009) 'Digital Wills: Has the Time Come for Wills to Join the Digital Revolution?', *ResearchGate*, 33, p. 291. doi:[https://www.researchgate.net/publication/228223096\\_Digital\\_Wills\\_Has\\_the\\_Time\\_Come\\_for\\_Wills\\_to\\_Join\\_the\\_Digital\\_Revolution](https://www.researchgate.net/publication/228223096_Digital_Wills_Has_the_Time_Come_for_Wills_to_Join_the_Digital_Revolution).
9. Милошевић, Д.Т.Ђ. (2022) *ЕЛЕКТРОНСКИ ТЕСТАМЕНТ*. pdf. Gjetur në: <https://scidar.kg.ac.rs/bitstream/123456789/14595/1/18%20%20Zbornik-19-1082-405-414.pdf>
10. Banta, N.M. *ELECTRONIC WILLS AND DIGITAL ASSETS: REASSESSING FORMALITY IN THE DIGITAL AGE*, pp. 584–587. Gjetur në: <https://www.baylor.edu/law/review/doc.php/350624.pdf>
11. Horton, D. and Weisbord, R.K. (2020) *COVID-19 and Formal Wills*. Gjetur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3572097](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3572097)

## Akte Normative:

1. Ligji për trashëgimi (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.47/1996)
2. Ligji për procedurë jashtëkontestimore (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.9/2008)
3. Ligji për noteri (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 72/16)
4. NRS: CHAPTER 133 - WILLS (no date) [www.leg.state.nv.us](http://www.leg.state.nv.us). Gjetur në: <https://www.leg.state.nv.us/nrs/nrs-133.html>
5. (2023) [Scholarship.law.upenn.edu](http://scholarship.law.upenn.edu). Gjetur në: [https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3607&context=penn\\_law\\_review](https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3607&context=penn_law_review)
6. *2012 Ohio Revised Code :: Title [21] XXI COURTS - PROBATE - JUVENILE :: Chapter 2107 - WILLS :: Section 2107.03 - Method of making will. Justia Law.* Gjetur në: <https://law.justia.com/codes/ohio/2012/title-21/chapter-2107/section-2107.03/>
7. *House Bill 483 (2021) - The Florida Senate (no date) www.flsenate.gov.* Gjetur në: <https://www.flsenate.gov/Session/Bill/2021/483>
8. *View Document (no date).* Gjetur në: [www.azleg.gov](http://www.azleg.gov). <https://www.azleg.gov/viewdocument/?docName=https://www.azleg.gov/ars/14/02518.htm>
9. *Electronic wills act (2021) Electronic Wills Act - Uniform Law Commission.* Gjetur në: <https://www.uniformlaws.org/viewdocument/final-act-60?CommunityKey=a0a16f19-97a8-4f86-afc1b1c0e051fc71&tab=librarydocuments>

## Burime nga interneti:

1. <http://www.aleksov.mk/sq/procedura-trashegimore/>
2. <https://www.techopedia.com/definition/24747/cybersecurity>
3. <https://www.toppr.com/guides/essays/cyber-security-essay/>
4. <https://www.barrons.com/articles/pandemic-online-wills-51675125583>
5. <https://trustandwill.com/learn/electronic-will-in-nevada>
6. <https://www.daytonestateplanninglaw.com/electronic-wills-ohio/>
7. <https://www.daytonestateplanninglaw.com/electronic-wills-ohio>

8. <https://www.novaestatelawyers.com/electronic-wills-in-virginia/>
9. <https://trustandwill.com/learn/virginia-online-will>
10. <https://trustandwill.com/learn/electronic-will-in-arizona>
11. <https://caselaw.findlaw.com/court/tn-court-of-appeals/1109985.html>